# PROGRAMI AC141: MBËSHTETJA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

## Permbajtja


1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit .......... 2
2. Qëllimet dhe objektivat e politikës së programit .......... 8
3. Plani i shpenzimeve të produkteve të programit .......... 11
4. Projektet e investimeve te programit .......... 13
5. Të dhëna mbi programin .......... 14
6. Projektet e planifikuara për PBA 2027-2029 .......... 17

## HYRJE

### 1. Përshkrim i Përgjithshëm i Programit

**Vështrim i përgjithshëm**

Bashkia Shkodër synon të ndërtojë një model zhvillimi të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, duke shfrytëzuar në mënyrë strategjike burimet dhe avantazhet që ka në dispozicion.
Objektivi kryesor është të kthehen këto avantazhe në mundësi konkrete për zhvillim social dhe ekonomik, në mënyrë që çdo zonë e territorit të kontribuojë në përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme.
Bashkia përqendrohet në krijimin e një klime të favorshme për sipërmarrjet lokale, nxitjen e investimeve, bashkëpunimin me komunitetin e biznesit dhe me diasporën, si dhe në lidhje të ngushta me partnerët ndërkombëtarë. Po ashtu, zhvillimi ekonomik trajtohet në mënyrë të balancuar, duke mbështetur ndërveprimin mes qytetit dhe zonave rurale.
Ndër prioritetet janë përmirësimi i infrastrukturës së tregjeve lokale, forcimi i kapaciteteve prodhuese të fermerëve dhe zhvillimi rural. Vëmendje e veçantë i kushtohet turizmit, duke u përpjekur për të ndërtuar një ofertë turistike konkuruese, të qëndrueshme dhe të bazuar në vlerat natyrore, kulturore dhe njerëzore të zonës.

**Programi për mbështetjen e zhvillimit ekonomik** synon të nxisë një zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të territorit përmes planifikimit strategjik, promovimit të turizmit dhe mbështetjes së sektorit bujqësor. Nëpërmjet politikave aktive për rritjen ekonomike, diversifikimin e produkteve turistike dhe fuqizimin e fermerëve e agro-përpunuesve lokalë, programi kontribuon në krijimin e mundësive të reja të punësimit, përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e balancuar midis zonave urbane dhe rurale të bashkisë.
Nxitja e zhvillimit ekonomik varet nga dy faktorë kryesorë: hartimi dhe monitorimi i politikave të duhura dhe dokumenteve strategjike dhe përthithja e investimeve dhe ndihmës së huaj dhe vendase**.** Një klimë e favorshme biznesi është thelbësore për arritjen e këtyre objektivave, ndaj Bashkia Shkodër, po zbaton politika që mbështesin zhvillimin e një ekonomie të qëndrueshme dhe konkurruese, në përputhje me parimin e plotësueshmërisë ndërmjet qytetit dhe zonave rurale**.**

Bashkia Shkodër gjatë viteve të fundit ka ndërmarrë disa nisma në drejtim të:

**Forcimit të bashkëpunimit institucional** me qëllim promovimin e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe lidhjen e tregut të punës me sektorët strategjikë të ekonomisë vendore;
**Nxitjes së sipërmarrjes për të rinj**, përmes mbështetjes financiare me grante, mentorimit dhe shkëmbimit të përvojave me ekspertë të fushës;
**Zhvillimit dhe rregullimit të tregjeve vendore**, mbështetje infrastrukturore për ngritjen dhe funksionimin e tregjeve të reja, në mënyrë që të lehtësohet qarkullimi i produkteve vendore dhe të forcohen zinxhirët lokalë të vlerës;
**Zhvillimit të politikave për migracionin dhe diasporën**, duke bashkëpunuar me organizata

ndërkombëtare për asistencë teknike dhe nxitjen e bashkëpunimit me komunitete shqiptare jashtë vendit në projekte të ndryshme;

**Integrimit europian** si proces i cili duhet të integrohet në politikat e zhvillimit lokal, përmes harmonizimit të praktikave me standardet e BE-së dhe pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare që mbështesin zhvillimin e territorit dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.

Përmes këtyre masave synohet të forcohen kapacitetet lokale për zhvillim ekonomik, të rritet konkurrueshmëria e territorit të Bashkisë Shkodër, dhe të krijohet një model i qëndrueshëm bashkëpunimi ndërmjet pushtetit vendor, sektorit privat, diasporës dhe institucioneve ndërkombëtare. Rëndësi të veçantë do t'i kushtohet gjithashtu integrimit të brezave të rinj në ekonomi, përmes nxitjes së sipërmarrjes, inovacionit dhe ndërmarrjeve sociale.

**Turizmi**, si aktivitet ndërsektoral, është i lidhur me shumë aktivitete ekonomike dhe ka një ndikim të jashtëzakonshëm në sektorë të ndryshëm, duke ofruar shërbime të lidhura me kohën e lirë dhe me udhëtimet e biznesit. Ai luan një rol të madh në zhvillim, pasi kontribuon në zhvillimin lokal, krijimin e vendeve të punës, zhvillimin e zonave në rënie industriale apo rurale, si dhe në rigjenerimin urban.

Qëllimi kryesor i aktivitetit të programit është promovimi i zhvillimi të turizmit nëpërmjet zbatimit të politikave favorizuese të këtij sektori. Programi zbatohet nga Bashkia e Shkodrës, aktiviteti i së cilës përqëndrohet në dy drejtime primare, që janë:

- zhvillimi i produktit turistik,
- shërbimi ndaj vizitorit.

Bashkia Shkodër, përmes promovimit aktiv të politikave, synon që industria e turizmit të kthehet në burimin kryesor të rritjes ekonomike dhe në një mjet për integrimin e territoreve më pak të zhvilluara dhe përmirësimin e ruajtjen e zonave të trashëgimisë.

Në kuadër **të zhvillimit rural dhe mbështetjes së ekonomisë bujqësore,** Bashkia Shkodër, synon forcimin e kapaciteteve të fermerëve dhe përmirësimin e kushteve të prodhimit bujqësor e blegtoral në territorin e saj. Mbështetja fokusohet në nxitjen e pjesëmarrjes së fermerëve dhe agro-përpunuesve në skemat kombëtare dhe ndërkombëtare të granteve, programet e qeverisë shqiptare dhe donatorë të huaj. Çdo vit orientohen dhe mbështeten me asistencë teknike për aplikime mesatarisht 400 fermerë.

Në vijim të punës për trajtimin veterinar të kafshëve të rrugës, vazhdon trajtimi i këtyre kafshëve nëpërmjet sterilizimit, kastrimit, vaksinimit dhe deheletizimit. Janë ngritur dy strehëza, që deri tani kanë një kapacitet prej rreth 230 qen. Duhet theksuar se strehëza e re, e cila pritet të përfundojë brenda këtij viti në territorin e ish-repartit ushtarak në Rrenc, në pronësi të Bashkisë Shkodër do të ketë një kapacitet akomodimi prej 300 qenësh, duke përforcuar ndjeshëm kapacitetet ekzistuese për menaxhimin e kafshëve të rrugës. Po ashtu, Bashkia Shkodër, ka ngritur klinikën veterinare e cila ofron shërbime të dedikuara për trajtimin e

| | | |
|---|---|---|
| kafshëve, si atyre të strehuara, ashtu edhe atyre që ndodhen ende në rrugë, duke siguruar një kujdes gjithëpërfshirës dhe të vazhdueshëm për mirëqenien e tyre. | | |
| **Kodi i programit** | **Emri i Programit** | **Përshkrimi i programit** |
| **AC141** | Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural | • Hartimi i planeve strategjike të zhvillimit të programeve për zhvillimin ekonomik;<br>• Hartimi, zbatimi dhe monitorimi i politikave të përgjithshme ekonomike dhe tregtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore;<br>• Mbajtja e kontakteve me qeverisjen qendrore dhe biznesin për të garantuar politika zhvilluese në nivel rajonal dhe garantimin e zhvillimit ekonomik;<br>• Mbështetje me politika vendore dhe promovim i bizneseve lokale në funksion të zhvillimit ekonomik dhe tregtar brenda territorit të njësisë vendore ;<br>• Organizim i shërbimeve në mbështetje të zhvillimit ekonomik vendor, si informacion mbi bizneset, aktivitete promovuese etj.<br>• Publikimi i broshurave informative, krijimi i portaleve me profil ekonomik etj.<br>• Dhënia e granteve financiare për mbështetjen e aktiviteteve të biznesit të vogël e të mesëm, sipas mënyrës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi, duke garantuar akses të balancuar gjinor.<br>• Krijimi i strukturës së posaçme për diasporën dhe migracionin, për administrimin e shërbimeve në nivel vendor, si pjesë administrative e njësisë së vetëqeverisjes vendore;<br>• Rregullimi i veprimtarive në sheshet e tregjeve vendore ose mbështetje për infrastrukturën e tregjeve;<br>• Rritja e kapaciteteve përmes ngritjes dhe funksionimit të tregjeve të reja vendore dhe të rrjetit të tregtisë.<br>• Bashkërendimi dhe koordinimi i procesit të integrimit evropian në nivel vendor |
| | | • Ndërtim, mirëmbajtje, përmirësim dhe funksionim i strukturave përkatese me qëllim nxitjen e projekteve me karakter zhvillimor për njësinë vendore;<br>• Hartim dhe monitorim i projekteve që kanë për |

| | | |
|---|---|---|
| | | qëllim zhvillimin e qendrueshëm të njësisë së vetëqeverisjes vendore;<br>• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të turizmit vendor; promovim dhe zhvillim i turizmit vendor.<br>• Funksionimi i zyrave turistike vendore, organizim i fushatave publicitare, duke përfshirë prodhimin dhe shpërndarjen e literaturës promovuese e të një natyre të ngjashme;<br>• Përmirësim i hapësirave pamore urbane të Bashkisë, përmesmirëmbajtjes së objekteve kulturore dhe turistike që nxisin rritjen e vizitorëve duke e kthyer në atraksion turistik njësinë vendore.<br>• Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave.<br>• Informacion i përgjithshëm , dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore.<br>• Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë; mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra; mbikëqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujëra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra dhe liçensave të gjuetisë.<br>• Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural.<br>• Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokës.<br>• Administrimi, shfrytezimi dhe mirembajtja e infrastruktures se ujitjes dhe kullimit.<br>• Trajtimi veterinar i kafsheve te rruges. |

**Raporti:PBA3 - Shpenzimet e NJVQV dhe Programit sipas Klasifikimit Ekonomik**
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi:AC141 - Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural
PBA: 2027 - 2029
Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| KODI | EMËRTIMI I LLOGARISË | FAKTI 2024 | FAKTI 2025 | FILLESTAR 2026 | RISHIKUAR 2026 | PLANI 2027 | PLANI 2028 | PLANI 2029 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Shpenzime Personeli (600-601)** | **23,430** | **24,098** | **27,903** | **37,490** | **29,706** | **29,706** | **29,706** |
| 600 | Paga, shperblime dhe te tjera shpenzime personeli | 20,080 | 20,650 | 24,074 | 32,450 | 25,629 | 25,629 | 25,629 |
| 601 | Kontribute per sigurime shoqerore dhe shendetesore | 3,350 | 3,448 | 3,829 | 5,040 | 4,077 | 4,077 | 4,077 |
| | **Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)** | **21,010** | **63,190** | **29,522** | **42,477** | **27,456** | **29,356** | **25,356** |
| 602 | Mallra dhe sherbime te tjera | 9,677 | 12,530 | 15,982 | 24,239 | 16,956 | 17,156 | 17,156 |
| 604 | Transferime korrente te brendeshme | 11,333 | 50,660 | 13,540 | 18,238 | 10,500 | 12,200 | 8,200 |
| | **Shpenzime Kapitale (230-232, 255)** | **20,698** | **17,593** | **8,294** | **81,517** | **650** | **0** | **0** |
| 230 | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te patrupezuara | 0 | 1,359 | 123 | 462 | 0 | 0 | 0 |
| 231 | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara | 20,698 | 16,234 | 8,171 | 81,055 | 650 | 0 | 0 |
| | **Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja)** | **0** | **0** | **2,402** | **2,402** | **3,348** | **0** | **0** |
| 602 | Mallra dhe sherbime te tjera | 0 | 0 | 2,402 | 2,402 | 3,348 | 0 | 0 |
| | **Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja)** | **0** | **0** | **0** | **1,729** | **0** | **0** | **0** |
| 231 | Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme te trupezuara | 0 | 0 | 0 | 1,729 | 0 | 0 | 0 |
| **TOTALI** | | **65,139** | **104,880** | **68,120** | **165,615** | **61,161** | **59,062** | **55,062** |

| **Komente** |
| --- |
| **Programi AC141: Mbeshtetje per zhillimin ekonomik vendor dhe rural,** ka si burim financimi transfertën e pakushtëzuar, të ardhura të tjera dhe donacionet.<br><br>Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore zënë:<br>• 48.57 % në vitin 2027<br>• 50.3 % në vitin 2028<br>• 53.95 % në vitin 2029<br><br>Shpenzimet korrente zënë:<br>• 50.37 % në vitin 2027<br>• 49.7 % në vitin 2028<br>• 46.05 % në vitin 2029<br><br>Shpenzimet kapitale zënë 1.06 % në vitin 2027 |

## 2. Qëllimet dhe objektivat e politikës së programit

**Raporti: PBA6 - Deklarata së Politikës së Programit**
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AC141 - Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural PBA: 2027 - 2029

| Përshkrimi i Politikës së Programit |
|---|
| Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve të përgjithshme ekonomike dhe tregtare; Forcimi i zhvillimit ekonomik dhe punësimit vendor; Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi :Zhvillimi i turizmit; Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i politikave per sistemin e ujitjes dhe kullimit. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Zhvillimi lokal i udhëhequr nga komuniteti duke nxitur kohezionin territorial përmes hartimit të planeve dhe programeve zhvillimore duke mbështetur dhe koordinuar strukturat e bashkisë, në realizimin e reformave për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga proçesi i Integrimit Evropian. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2026 | | 2030 | |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit . E Ulet *(%)* | 34 | | 0 | |
| | Përqindja e ecurise së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit. E mesme *(%)* | 45 | | 18 | |
| | Përqindja e ecurisë se projekteve në Dokumentin e Strategjise territoriale të zhvillimit. E mire *(%)* | 21 | | 82 | |
| | Numri i projekteve te fituara/ndihma e huaj dhe fonde te brendshme kundrejt numrit te projekteve te *(%)* | 50 | | 45 | |
| 1.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre ne bashkepunim me institucionet e specializuara dhe aktoret e interesuar. Programimi dhe zbatimi eficent i financimeve te programeve te BE-se dhe donatoreve te tjere si dhe forcimi i marredhenieve me diasporen. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
| | Përqindja e ecurisë së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit. E ulet *(%)* | 34 | 28 | 19 | 14 |
| | Përqindja e ecurise së projekteve në Dokumentin e Strategjisë territoriale të zhvillimit . E mesme *(%)* | 45 | 42 | 41 | 39 |
| | Përqindja e ecurisë se projekteve në Dokumentin e Strategjise territoriale të zhvillimit. E mire *(%)* | 21 | 34 | 40 | 47 |
| | Numri i projekteve të aplikuara sipas RELOAD ( metodologjia Reload) *(numer)* | 25 | 12 | 12 | 0 |
| | Nr i projekteve te fituara/ndihma e huaj dhe fonde te brendshme kundrejt nr te projekteve te aplikua *(%)* | 50 | 50 | 58 | 58 |
| | Nr. i aktiviteteve me karakter informues *(numer)* | 45 | 45 | 45 | 45 |
| | Nr. i personave te informuar *(numer)* | 350 | 350 | 350 | 350 |
| | Numri i programeve te fituara *(numer)* | 1 | 1 | 1 | 0 |
| | Numri i perfituesve *(numer)* | 150 | 150 | 0 | 0 |
| 1.2 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Permiresimi i klimes se biznesit permes panaireve, ofrimit te sherbimeve mbeshtetese, publikimeve te materialeve promocionale si dhe incentivave financiare ne mbeshtetje te biznesit te vogel. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
| | Nr. i bizneseve te mbeshtetura per zhvillim *(nr.)* | 135 | 135 | 135 | 135 |
| | Nr. i sipermarresve te rinj te mbeshtetur ne sektorin AGRO *(nr.)* | 35 | 35 | 45 | 45 |
| | Nr. i bizneseve te asistuara ne aplikime dhe skema financiare *(nr.)* | 10 | 10 | 10 | 10 |
| 2 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Ngritja dhe funksionimi i tregjeve publike dhe i rrjetit të tregtisë. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2026 | | 2030 | |
| | Përqindja e njësive të tregjeve publike funksionale të mirëmbajtura në raport me totalin *(%)* | 50 | | 67 | |
| 2.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
| | Numri total i vendeve te shitjes ne tregje publike *(nr)* | 240 | 240 | 300 | 300 |
| | Përqindja e njësive të tregjeve publike funksionale të mirëmbajtura në raport me totalin *(%)* | 50 | 50 | 67 | 67 |
| | Përmirësimi i infrastrukturës së tregjeve vendore nëpërmjet investimeve - *(numer)* | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Nxitja e zhvillimit të turizmit të zonës dhe rritja e vlerës së territorit te Bashkisë Shkodër, si destinacion turistik, duke forcuar identitetin e saj unik kulturor, social, mjedisor dhe ekonomik. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2026 | | 2030 | |
| | Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit -Materiale promovuese dhe informuese turistike .. *(numer)* | 7900 | | 8500 | |
| | Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit *(nr)* | 5 | | 6 | |
| 3.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale dhe informative. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
| | Komunikimi nëpërmjet platformave online dhe materialeve promovuese/ informuese. *(numer)* | 75000 | 75000 | 90000 | 100000 |
| | Përmirësimi i shërbimit të promovimit turizmit -Materiale promovuese dhe informuese turistike.. *(numer)* | 7900 | 7900 | 8500 | 8500 |
| | Numri I shtigjeve te mirembajtura *(numer)* | 3 | 3 | 3 | 3 |
| | Pjesëmarrje në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare *(numer)* | 3 | 3 | 3 | 3 |
| | Numri i aktiviteteve të organizuara nga Drejtoria e Turizmit *(Nr)* | 5 | 6 | 6 | 6 |
| | Numri i fushatave te marketingut online *(Nr)* | 1 | 1 | 1 | 1 |
| | Ide inovative per zhvillimin e turizmit te qendrueshem- numri i iniciativave per promovimin online *(Nr.)* | 1 | 1 | 1 | 1 |
| | Akses i permiresuar ne plazhe ( infrastrukture e permiresuar ne numer) *(Nr.)* | 1 | 1 | 1 | 1 |
| | Certifikimi " ECO Destination" *(Nr.)* | 1 | 1 | 1 | 1 |
| 4 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Funksionimi i zyrave vendore turistike përmes koordinimit të aktorëve dhe strukturave përgjegjëse në industrinë turistike; Marketing i vlerave dhe potencialeve të komunitetit. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2026 | | 2030 | |
| | Permiresimi I sherbimit ne sektorin e turizmit. Numri I personave te akomoduar *(nr)* | 428210 | | 428500 | |
| | Rritja e të ardhurave të bashkisë nga turizmi : Të ardhurat nga taksa e hoteleve kundrejt totalit *(%)* | 4 | | 5 | |
| 4.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për zhvillimin e turizmit. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
| | Permiresimi i sherbimit ne turizmit. Nr. i personave te akomoduar ne hoteleerbimit ne sekt *(nr)* | 428210 | 428500 | 428500 | 428500 |
| | Rritja e te ardhura te bashkise nga turizmi. te ardhurat nga taksa e hoteleve. Kundrejt vitit te kal *(%)* | 4 | 4 | 4 | 5 |
| | Permiresimi i sherbimit te promovimit te turizmit- nr. i turisteve qe marrin info *(numer)* | 17000 | 18000 | 19000 | 19000 |
| 5 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Mbikqyrja dhe mbajtja nën kontroll e qenve endacakë | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2026 | | 2030 | |
| | Qente në rrugë qe perfitojne sherbime dhe trajtohen *(numer)* | 510 | | 510 | |
| 5.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Trajtimi veterinar i kafshëve të rrugës | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Qente në rrugë qe perfitojne sherbime dhe trajtohen. *(numer)* | 510 | 510 | 510 | 510 |
| 6 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Mbështetja për përmirësimin e cilësisë së jetës , veprimtarive bujqësore dhe ekonomike.<br>Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqesore, krijimi i informacionit kadastral dhe bujqësor.<br>Administrimi,shfrytezimi dhe mirembajtja e infrastruktures se ujitjes dhe kullimit. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2026 | | 2030 | |
| | Regjistri kadastral sipas fshatrave per te gjithe territorin e bashkise ,manual dhe elektronik *(numer)* | 92 | | 92 | |
| 6.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Krijimi dhe perditesimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës bujqesore dhe perditesimi i databazes se informacionit bujqesor. Permiresimi i sistemit te ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, furnizim me uje për vaditje të fermave bujqësore | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2026 | 2027 | 2028 | 2029 |
| | Regjistri kadastral sipas fshatrave per te gjithe territorin e bashkise ,manual dhe elektronik / *(numer)* | 92 | 92 | 92 | 92 |
| | Sistem i ngritur dhe i përditësuar i fondit të tokës bujqësore ne baze ferme *(numer)* | 12900 | 13000 | 13100 | 13200 |
| | Përditesim i database me identifikimin e njësive bujqesore aktive *(numer)* | 450 | 450 | 450 | 450 |
| | Bashkëpunimi i njësive bujqësore me agroperpunues, tregtar inputesh dhe produktesh bujqësore *(numer)* | 9 | 9 | 9 | 9 |
| | Përmirësimi rrjetit kullues:- Nr. Projekte pastrimi kanale ujitese dhe kulluese hartuar *(numer)* | 250 | 250 | 250 | 250 |

## 3. Plani i shpenzimeve të produkteve të programit

**Raporti: PBA7 - Shpenzimet e Produkteve të Programit**
Vlerat paraqiten në: 000 ALL
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AC141 - Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural
PBA: 2027 - 2029 Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 1.1 - Hartimi i Strategjive, Planeve Zhvillimore lokale dhe monitorimi i tyre ne bashkepunim me institucionet e specializuara dhe aktoret e interesuar. Programimi dhe zbatimi eficent i financimeve te programeve te BE-se dhe donatoreve te tjere si dhe forcimi i marredhenieve me diasporen. | | | |
| Produkti | V413AAA - Plani Strategjik i Zhvillimit | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Ky produkt përfshin të gjitha aktivitetet dhe kostot përkatëse në lidhje me hartimin apo rishikimin e planit strategjik të zhvillimit të NJVQV. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. projekte | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |
| Sasia | 198 | 198 | 198 | 198 |
| Shpenzime Totale | 4,779 | 4,000 | 5,900 | 1,900 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 24.137 | 20.202 | 29.798 | 9.596 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -16.00% | 48.00% | -68.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -16.00% | 48.00% | -68.00% |
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 1.2 - Permiresimi i klimes se biznesit permes panaireve, ofrimit te sherbimeve mbeshtetese, publikimeve te materialeve promocionale si dhe incentivave financiare ne mbeshtetje te biznesit te vogel. | | | |
| Produkti | V413AAB - Mbështetje me Grante për Biznesin e Vogël | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Ky produkt paraqet buxhetin e caktuar nga NJVQV për skemën e granteve konkuruese që do të akordohen me qëllim zhvillimin e startup-eve, biznesit të vogël, etj. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |
| Sasia | 135 | 135 | 135 | 135 |
| Shpenzime Totale | 7,579 | 5,000 | 5,000 | 5,000 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 56.141 | 37.037 | 37.037 | 37.037 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -34.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -34.00% | 0.00% | 0.00% |
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 2.1 - Sistemimi dhe ngritja e tregjeve të shitjes me shumicë dhe pakicë në territorin e Shkodrës. | | | |
| Produkti | V416AAB - Subjekte të Sistemuara në Tregun e Ushqimeve | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Materiale konsumi, energjia elektrike, sherbimi dhe materiale të tjera mirëmbajtjeje, materiale hidraulike, shpenzime mirembajtje kaldaje, materiale ndricimi, pagesa e ujit, shpenzime pastrimi dhe disifektimi, shpenzime sigurimi, etj. për tregun ushqimor. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |
| Sasia | 120 | 120 | 200 | 200 |
| Shpenzime Totale | 5,494 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 45.787 | 0.000 | 0.000 | 0.000 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 67.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -100.00% | | |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -100.00% | | |
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 3.1 - Promovim i territorit të Bashkisë nërpërmjet prodhimit dhe botimit të materialeve promocionale dhe informative. | | | |
| Produkti | V476AAB - Promovimi i Turizmit | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Promovimi i turizmit realizohet, por nuk kufizohet në shërbimet e Zyrës së Info Point, promovimi i destinacioneve të ndryshme turistike; hartimi dhe shërndarja e hartave turistike, udhërrëfyesve, etj.; realizimi i aktiviteteve të ndryshme promovuese si Dita Boterore e Edukimit; dita boterore e turizmit; etj. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Sasia | 7,900 | 7,900 | 8,500 | 8,500 |
| Shpenzime Totale | 13,627 | 12,150 | 12,150 | 12,150 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 1.725 | 1.538 | 1.429 | 1.429 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 8.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -11.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -11.00% | -7.00% | 0.00% |
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 4.1 - Forcimi institucional nëpërmjet ngritjes së strukturave te dedikuara për zhvillimin e turizmit. | | | |
| Produkti | V476AAA - Shërbimi i Stafit të Zhvillimit të Turizmit | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Ofrimi i shërbimit turistik dhe pagesa e pagave e sigurimeve për stafin e turizmit dhe mbështetjen operative. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |
| Sasia | 13 | 13 | 13 | 13 |
| Shpenzime Totale | 27,200 | 20,315 | 20,315 | 20,315 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 2,092.310 | 1,562.692 | 1,562.692 | 1,562.692 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -25.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -25.00% | 0.00% | 0.00% |
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 5.1 - Trajtimi veterinar i kafshëve të rrugës | | | |
| Produkti | V422AAB - Trajtim I kafshëve endacake | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Shpenzime për trajtimin e kafshëve endacake (ushqime, disterilizime etj) në formë ambulante apo nëpërmjet qendrave të ngritura për këtë qëllim. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |
| Sasia | 510 | 510 | 510 | 510 |
| Shpenzime Totale | 11,181 | 6,306 | 6,306 | 6,306 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 21.924 | 12.365 | 12.365 | 12.365 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -44.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -44.00% | 0.00% | 0.00% |
| Objektivi i Politikës së Programit | Ob 6.1 - Krijimi dhe perditesimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës bujqesore dhe perditesimi i databazes se informacionit bujqesor. Permiresimi i sistemit te ujitjes dhe kullimit. Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, furnizim me uje për vaditje të fermave bujqësore | | | |
| Produkti | V422AAD - Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor | | | |
| Përshkrimi i Produktit | Ky produkt përfshin aktivitetet dhe kostot përkatëse të lidhura shërbimin e këshillimit dhe ekstensionit bujqësor. | | | |
| Njësia e Matjes | Nr. | | | |
| | **2026 Buxheti** | **2027 Plani** | **2028 Plani** | **2029 Plani** |
| Sasia | 400 | 400 | 400 | 400 |
| Shpenzime Totale | 11,390 | 9,391 | 9,391 | 9,391 |
| Shpenzime Totale për Njësi | 28.475 | 23.478 | 23.478 | 23.478 |
| Ndryshimi në % i Sasisë | | 0.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve Totale | | -18.00% | 0.00% | 0.00% |
| Ndryshimi në % i Shpenzimeve për Njësi | | -18.00% | 0.00% | 0.00% |

## 4. Projektet e investimeve te programit

**Raporti: PBA8 - Projektet e Investimeve**
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
PBA: 2027 - 2029 Vlerat paraqiten në: 000 ALL
Programi: AC141 - Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural

| KODI | EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT | BURIMI I FINANCIMIT | DATA E FILLIMIT | DATA E PËRFUNDIMIT | KOSTO TOTALE | 2024 FAKTI | 2025 FAKTI | 2026 BUXHETI | 2027 PLANI | 2028 PLANI | 2029 PLANI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet Kapitale sipas Projekteve** | | | | | | | | | | | |
| P422AAG | Rikonstruksion streheza e re e qenve. Faza II | Financim i Brendshëm | 02/02/2026 | 31/12/2026 | 7,664 | 0 | 0 | 7,664 | 0 | 0 | 0 |
| P413AAI | Arti për Europën | Financim I Huaj | 01/01/2026 | 31/12/2027 | 6,530 | 0 | 0 | 130 | 650 | 0 | 0 |
| P413AAL | Furnizim vendosje e tabelave informuese (digjitale) | Financim i Huaj | 27/02/2026 | 31/12/2026 | 2,814 | 0 | 0 | 2,814 | 0 | 0 | 0 |
| P422AAA | Ndertim i strehëzes së re të qenëve dhe Rrethim oborri strehëza e qenëve dhe kolibe për qen | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2026 | 17,431 | 0 | 0 | 17,431 | 0 | 0 | 0 |
| P424AAM | Kanali kryesor Mjedë KU-22 Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-23 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-23-1 Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-1 Bëltojë, Trush; Kanali kryesor Mjedë KU-22-2 Bëltojë, Trush | Financim i Brendshëm | 10/10/2024 | 31/12/2025 | 1,757 | 0 | 1,312 | 445 | 0 | 0 | 0 |
| P424AAO | Vepra e marrjes Spathar KU-10 Vukatanë- Kuç | Financim i Brendshëm | 10/10/2024 | 31/12/2025 | 1,349 | 0 | 1,013 | 336 | 0 | 0 | 0 |
| P424AAP | KU-32-33 Berdice | Financim i Brendshëm | 01/01/2024 | 31/12/2025 | 1,210 | 0 | 1,083 | 127 | 0 | 0 | 0 |
| P476AAG | Ndërtimi i Zyrës së re InfoPoint | Financim i Brendshëm | 01/07/2025 | 31/12/2026 | 8,574 | 0 | 243 | 8,331 | 0 | 0 | 0 |
| P413AAE | Rikualifikim merkates Rus(Mbulesa e Tregut) | Financim i Brendshëm | 02/01/2023 | 31/12/2025 | 12,840 | 0 | 12,826 | 14 | 0 | 0 | 0 |
| P413AAF | Rikualifikimin e godinës së Merkatës Rus | Financim i Brendshëm | 01/01/2025 | 31/12/2026 | 44,496 | 0 | 0 | 44,496 | 0 | 0 | 0 |
| P424AAS | Zbatimi i projekteve teknike per mbrojtjen e tokes bujqesore nga erozioni me mbeshtetje te GIZ | Financim i Huaj | 01/01/2025 | 31/12/2025 | 174 | 0 | 0 | 174 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Projekteve** | | | | | 104,839 | 0 | 16,477 | 81,962 | 650 | 0 | 0 |
| **Shpenzimet Kapitale sipas Produkteve** | | | | | | | | | | | |
| **KODI** | **EMËRTIMI I PROJEKTIT/PRODUKTIT** | **BURIMI I FINANCIMIT** | **DATA E FILLIMIT** | **DATA E PËRFUNDIMIT** | **KOSTO TOTALE** | **2024 FAKTI** | **2025 FAKTI** | **2026 BUXHETI** | **2027 PLANI** | **2028 PLANI** | **2029 PLANI** |
| V413AAA | Plani Strategjik i Zhvillimit | | | | | 0 | 0 | 184 | 0 | 0 | 0 |
| V476AAA | Shërbimi i Stafit të Zhvillimit të Turizmit | | | | | 0 | 0 | 1,100 | 0 | 0 | 0 |
| **Totali i Shpenzimeve Kapitale sipas Produkteve** | | | | | | 0 | 0 | 1,284 | 0 | 0 | 0 |
| | **Totali i Përgjithshëm** | | | | | 0 | 16,477 | 83,246 | 650 | 0 | 0 |

## 5. Të dhëna mbi programin

**Raporti: PBA9 - Informacion mbi Programin**
NJVQV: 141 - Bashkia Shkodër
Programi: AC141 - Mbështetje për Zhvillimin Ekonomik Vendor dhe Rural
PBA: 2027 - 2029

| | | FUNKSIONI | TË PËRGJITHSHME | 2022 | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **NUMRI I PROJEKTEVE GJITHSEJ TE DOKUMENTIT TE STRATEGJISE TERRITORIALE TE ZHVILLIMIT TE BASHKISE SHKODER** | 04130 - Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 0.00 | 198.00 | 198.00 | 198.00 | 198.00 | 198.00 |
| 2 | **NUMRI I PROJEKTEVE TE REALIZUARA NE PBA ME ECURI TE ULET ZBATIMI** | | 0.00 | 103.00 | 95.00 | 92.00 | 67.00 | 67.00 |
| 3 | **NUMRI I PROJEKTEVE TE REALIZUARA NE PBA ME ECURI TE MESME ZBATIMI** | | 0.00 | 70.00 | 87.00 | 88.00 | 90.00 | 90.00 |
| 4 | **NUMRI I PROJEKTEVE TE REALIZUARA NE PBA ME ECURI TE MIRE ZBATIMI** | | 0.00 | 25.00 | 16.00 | 18.00 | 41.00 | 41.00 |
| 5 | **NUMRI I PROJEKTEVE TE APLIKUARA SIPAS RELOAD ( METODOLOGJIA RELOAD)** | | 0.00 | 15.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 25.00 |
| 6 | **NUMRI I PROJEKTEVE TE FITUARA SIPAS PROGRAMEVE TE FINANCUARA NGA BE DHE ORGANIZATA TE TJERA NDERKOMBETARE** | | 0.00 | 11.00 | 7.00 | 7.00 | 10.00 | 5.00 |
| 7 | **NUMRI I PROJEKTEVE TE APLIKUARA SIPAS PROGRAMEVE TE FINANCUARA NGA BE DHE ORGANIZATA TE TJERA NDERKOMBETARE** | | 0.00 | 18.00 | 12.00 | 23.00 | 28.00 | 10.00 |
| 8 | **NUMRI I BIZNESEVE TE MBESHTETURA PER ZHVILLIM** | | 0.00 | 200.00 | 135.00 | 120.00 | 135.00 | 135.00 |
| 9 | **NUMRI I SIPERMARRESVE TE RINJ TE MBESHTETUR NE SEKTORIN AGRO** | | 0.00 | 0.00 | 25.00 | 30.00 | 35.00 | 35.00 |
| 10 | **NUMRI I BIZNESEVE TE ASISTUARA NE APLIKIME NE PROGRAME DHE SKEMA FINANCIARE** | 04130 - Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 0.00 | 25.00 | 25.00 | 25.00 | 4.00 | 10.00 |
| 11 | **NUMRI TOTAL I VENDEVE TE SHITJES NE TREGJET PUBLIKE** | | 0.00 | 230.00 | 230.00 | 230.00 | 240.00 | 240.00 |
| 12 | **NUMRI I VENDEVE TE SHITJES NE TREGJE PUBLIKE TE MIREMBAJTURA ( PAGESE E SHERBIMEVE UTILITARE DHE RIPARIM VENDE SHITJEJE)** | | 0.00 | 120.00 | 120.00 | 120.00 | 120.00 | 120.00 |
| 13 | **NUMRI I TREGJEVE FUNKSIONALE ME KRITERET E LEJES PERKATESE** | | 0.00 | 4.00 | 2.00 | 4.00 | 3.00 | 4.00 |
| 14 | **NUMRI I AKTIVITETEVE ME KARAKTER INFORMUES** | | 0.00 | 45.00 | 45.00 | 45.00 | 45.00 | 45.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 15 | **NUMRI I PERSONAVE TE INFORMUAR** | | 0.00 | 240.00 | 280.00 | 350.00 | 350.00 | 350.00 |
| 16 | **NUMRI I PERSONAVE TE INFORMUAR NE LIDHJE ME DIASPOREN DHE MIGRACIONIN** | | 0.00 | 0.00 | 100.00 | 150.00 | 200.00 | 200.00 |
| 17 | **NUMRI I VIZITOREVE NE FAQEN E TURIZMIT** | 04760 - Turizmi | 0.00 | 67,000.00 | 69,000.00 | 5,200.00 | 295,000.00 | 75,000.00 |
| 18 | **NUMRI I SHKARKIMEVE TE APLIKACIONIT** | | 0.00 | 35,000.00 | 40,000.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 19 | **NUMRI I SHTIGJEVE TE MIREMBAJTURA** | | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 2.00 | 3.00 | 3.00 |
| 20 | **NUMRI I MATERIALEVE PROMOCIONAL TE PRODHUARA ( HARTA, GUIDA, ETJ)** | | 0.00 | 6,800.00 | 7,000.00 | 6,200.00 | 5,500.00 | 7,900.00 |
| 21 | **PJESMARRJE NE PANAIRE KOMBETARE DHE NDERKOMBETARE** | | 0.00 | 3.00 | 2.00 | 0.00 | 1.00 | 3.00 |
| 22 | **NUMRI I AKTIVITETEVE TE ORGANIZUARA NGA DREJTORIA E TURIZMIT** | | 0.00 | 6.00 | 6.00 | 4.00 | 6.00 | 6.00 |
| 23 | **NUMRI I PUNONJESVE/STAFI I DREJTORISE SE TURIZMIT + DREJTORIA E PLANIFIKIMIT STRATEGJIK DHE PERMIRESIMIT TE KLIMES SE BIZNESIT** | | 0.00 | 16.00 | 13.00 | 13.00 | 13.00 | 13.00 |
| 24 | **NUMRI I INICIATIVAVE TE BIZNESEVE TURISTIKE TE MBESHTETURA** | | 0.00 | 20.00 | 5.00 | 1.00 | 1.00 | 1.00 |
| 25 | **NUMRI I TURISTEVE ( I PERSONAVE) TE AKOMODUAR NE HOTELE** | | 0.00 | 292,857.00 | 297,143.00 | 485,143.00 | 559,883.00 | 428,210.00 |
| 26 | **TE ARDHURA NGA TAKSA E QENDRIMIT NE HOTEL NE 000 LEKEE REALIZUAR** | | 0.00 | 20,500.00 | 26,609.00 | 33,960.00 | 40,778.00 | 33,000.00 |
| 27 | **TE ARDHURA NGA TAKSAT VENDORE NE 000 LEKE E REALIZUAR** | | 0.00 | 346,037.00 | 364,326.00 | 425,749.00 | 604,358.00 | 859,950.00 |
| 28 | **NUMRI I TURISTEVE QE MARRIN INFORMACION NGA ZYRA** | | 0.00 | 7,500.00 | 12,000.00 | 15,350.00 | 16,000.00 | 17,000.00 |
| 29 | **NUMRI I QENVE NE RRUGE QE PERFITOJNE SHERBIME DHE TRAJTOHEN. NUMRI I QENVE QE DO PAISEN ME GJURMUES.** | 04220 - Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve | 0.00 | 350.00 | 295.00 | 560.00 | 580.00 | 510.00 |
| 30 | **FERMERE TE MBESHTETUR PER ZHVILLIMIN RURAL DHE BUJQESOR** | | 0.00 | 0.00 | 324.00 | 520.00 | 380.00 | 400.00 |
| 31 | **REGJISTER KADASTRAL SIPAS FSHATRAVE PER TE GJITHE TERRITORIN E BASHKISE, MANUAL DHE ELEKTRONIK ( NUMER PROGRESIV)** | | 0.00 | 92.00 | 92.00 | 92.00 | 92.00 | 92.00 |
| 32 | **NUMER FERMA** | | 0.00 | 12,000.00 | 12,600.00 | 12,690.00 | 12,800.00 | 12,900.00 |
| 33 | **NUMRI I NJESIVE BUJQESORE AKTIVE TE PERDITESUARA NE DATABASE BUJQESORE** | | 0.00 | 350.00 | 380.00 | 420.00 | 450.00 | 450.00 |
| 34 | **NUMER PANAIRESH BUJQESORE QE SHERBEJNE PER PROMOVIM PRODUKTESH BUJQESORE DHE BLEGTORALE** | | 0.00 | 9.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 9.00 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 35 | **NR. PROJEKTE NDERHYRJE PASTRIMI NE KANALE UJITESE DHE KULLUESE HARTUAR** | 04240 - Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit | 0.00 | 244.00 | 238.00 | 238.00 | 140.00 | 250.00 |
| 36 | **NUMRI I PROGRAMEVE TE FITUARA** | 04130 - Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik | 0.00 | 1.00 | 1.00 | 1.00 | 1.00 | 1.00 |

## 6. Projektet e planifikuara për PBA 2027-2029

| Tabela 10: Emërtimet e aktiviteteve | | | | 000/lekë |
|---|---|---|---|---|
| **Produktet** | **Aktivitete/Projekte** | **PBA 2027-2029** | | |
| | | **2027** | **2028** | **2029** |
| | | **Totali** | **Totali** | **Totali** |
| **V413AAA. Plani Strategjik i Zhvillimit ( numër projekte )** | P.AC141.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër | - | - | - |
| | P.AC141.Q1.O1.A2. Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | 2,300 | 4,000 | - |
| | P.AC141.Q1.O1.A3.Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj | 800 | 800 | 800 |
| **P413AAI. Arti për Europën** | P.AC141.Q1.O1.A4.Projekti Arti per Europen - ARTE | 3,999 | - | - |
| **V413AAA. Plani Strategjik I zhvillimit ( numër projekte )** | P.AC141.Q1.O1.A5. Bashkia për BE-në | 400 | 500 | 500 |
| | P04130.Q1.O1 .A6 Diaspora dhe migracioni | 500 | 600 | 600 |
| **V413AAB - Mbështetje me Grante për Biznesin e Vogël (numër )** | P.AC141.Q1.O2.A1. Bashkëpunimi me Zonën e permirësimit të biznesit ne Shkoder | - | - | - |
| | P.AC141.Q1.O2.A2. Mbështetje per bizneset Agro | 2,000 | 2,000 | 2,000 |
| | P.AC141.Q1.O2.A3.Skemë Granti për biznese inovative | 3,000 | 3,000 | 3,000 |
| **TOTALI QELLIMI 1** | | **12,999** | **10,900** | **6,900** |
| **V416AAB. Subjekte të Sistemuara në Tregun e Ushqimeve (numër)** | P.AC141.Q2.O1.A1. Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | - | - | - |
| | P.AC141.Q2.O1.A2. Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | - | - | - |
| | P.AC141.Q2.O1.A3. Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale | - | - | - |
| | P.AC141.Q2.O1.A4. Rikualifikimi i godines Rus | - | - | - |
| **TOTALI QELLIMI 2** | | **-** | **-** | **-** |
| **V476AAB. Promovimi I Turizmit ( Numer Materiale promovuese dhe informuese turistike të prodhuara)** | P.AC141.Q3.O1.A1. Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë për web sitin e turizmit. | 150 | 150 | 150 |
| | P.AC141.Q3.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , pëditesim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit | - | - | - |
| | P.AC141.Q3.O1.A3. Prodhim, publikim dhe botim I materialeve promocionale | 2,500 | 2,500 | 2,500 |
| | P.AC141.Q3.O1.A4 Përmirësimi I aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P.AC141.Q3.O1.A5. Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | 1,500 | 1,500 | 1,500 |
| | P.AC141.Q3.O1.A6. Iteneraret e shijes/promovimi i Slow food | 1,500 | 1,500 | 1,500 |
| | P.AC141.Q3.O1.A7. Festa e Liqenit | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P.AC141.Q3.O1.A8 Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe natyrore te së zonave turistike, permes aktiviteteve promovuese. | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P.AC141.Q3.O1.A9.Java e mobilitetit | 500 | 500 | 500 |
| | P.AC141.Q3.O1.A10. Lojra Popullore Fest | 500 | 500 | 500 |
| | P.AC141.Q3.O1.A11. Fushate marketingu online | 500 | 500 | 500 |
| | P.AC141.Q3.O1.A12. Shkodra: Histori dhe magji ne çdo hap: promovim ne levizje | 1,000 | 1,000 | 1,000 |
| | P.AC141.Q3.O1.A13 Përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në plazhe dhe në destinacione të tjera turistike | 900 | 900 | 900 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | P.AC141.Q3.O1.A14. Shkodra: Green Destination | 100 | 100 | 100 |
| **V476AAA. Shërbimi i Stafit të Zhvillimit të Turizmit (numër punonjësish)** | P.AC141.Q4.O1.A2. Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorive në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive të mbeshtetjes per zhvillim ekonomik dhe turizem | 20,315 | 20,315 | 20,315 |
| **TOTALI QELLIMI 3+4** | | **32,465** | **32,465** | **32,465** |
| **PROGRAMI 4130 - MBESHTETJA PEER ZHVILLIM EKONOMIK** | | **45,464** | **43,365** | **39,365** |
| **V422AAB - Trajtimi i Kafshëve Endacake ( Numri i qenve trajtuar )** | P.AC141.Q5.O1.A1. Trajtimi i qenve të rrugës. | 6,306 | 6,306 | 6,306 |
| **V422AAD. Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor ( numër ferma )** | P.AC141.Q6.O1.A1.Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive te bujqesise | 2,607 | 2,607 | 2,607 |
| | P.AC141.Q6.O1.A2.Krijimi dhe përditesimi i kadastrës bujqësore dhe arshives se saj dhe futja në sistem e zonave të parilevuara | - | - | - |
| | P.AC141..Q6.O1.A3 Krijimi i informacionit bujqësor | - | - | - |
| | P.AC141..Q6.O1.A4.Sigurimi i mbështetjes se fermerëve për agroindustrinë, treg dhe marketing | - | - | - |
| | P.AC141.Q6.O1.A5.Promovim produktesh bujqësore dhe blegtorale nëpermjet panaireve | - | - | - |
| **04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve** | | **8,913** | **8,913** | **8,913** |
| **V422AAD. Fermerë të mbështetur për zhvillimin rural dhe bujqësor ( numër ferma )** | P.AC141.Q6.O1.A6.Vazhdimësia e menaxhimit të Drejtorise në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësive te sherbimit te ujitjes dhe kullimit | 6,784 | 6,784 | 6,784 |
| **04240 Menaxhimi I ujitjes dhe kullimit** | | **6,784** | **6,784** | **6,784** |
| **P.AC Mbështetje për zhvillimin ekonomik vendor dhe rural** | | **61,161** | **59,062** | **55,062** |

<table>
<tr><td>Nr. 1</td><td colspan="4">P.AC141.Q1.O1.A1. Monitorimi dhe Vlerësimi i strategjisë së zhvillimit të Bashkisë Shkodër</td><td colspan="5">Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural</td></tr>
<tr><td colspan="10">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</td></tr>
<tr><td colspan="10">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="10">Plani i Përgjithshëm Vendor (PPV) përfaqëson një instrument kyç për orientimin strategjik të zhvillimit afatgjatë të territorit të Bashkisë Shkodër. Ai përcakton vizionin zhvillimor të bashkisë, duke hartuar linjat udhëzuese për përdorimin e qëndrueshëm të tokës, zhvillimin ekonomik, infrastrukturën, shërbimet publike dhe mbrojtjen e mjedisit. Ky plan synon të maksimizojë potencialin e burimeve vendore përfshirë ato njerëzore, financiare dhe natyrore në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve dhe të zhvillimit të qëndrueshëm të komunitetit në tërësi.<br>Në këtë kuadër, monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të PPV-së përbëjnë një proces thelbësor për të garantuar që objektivat e parashikuara në plan po realizohen sipas pritshmërive dhe në përputhje me dinamikat reale të zhvillimit. Këto dy komponentë funksionojnë si mekanizma për ndjekjen sistematike të progresit, përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave, krahasimit të rezultateve të arritura me objektivat fillestare dhe identifikimit të devijimeve ose sfidave që mund të kenë ndikuar në zbatim.<br>Ky proces do të mundësojë gjithashtu krijimin e një kuadri të qartë raportimi dhe transparence për aktorët institucionalë dhe publikun, duke siguruar shpërndarjen e informacionit në mënyrë të hapur dhe të kuptueshme. Nëpërmjet monitorimit të rregullt dhe vlerësimeve të periudhës së ndërmjetme apo përfundimtare, Bashkia do të jetë në gjendje të nxjerrë konkluzione të vlefshme dhe rekomandime konkrete për përmirësimin e politikave të zhvillimit dhe për rishikimin e ndërhyrjeve prioritare në përputhje me nevojat aktuale të komunitetit dhe kapacitetet buxhetore të saj.</td></tr>
<tr><td colspan="10">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">Ky projekt synon të vendosë një mekanizëm funksional dhe të qëndrueshëm për ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor (PPV) të Bashkisë Shkodër. Qëllimi është të sigurohet një pasqyrë e qartë dhe e vazhdueshme mbi mënyrën se si po përdoren burimet financiare dhe teknike në përmbushjen e objektivave të planifikuara në PPV.</td></tr>
<tr><td colspan="10">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">1. Hartimi i planit për analizën e të dhënave;<br>2. Analizimi i të dhënave për ndikimin e planit, zbatimi i aktiviteteve përkatëse, arritja e qëllimeve të tij;<br>3. Gjetja e rekomandimeve dhe konkluzioneve;<br>4. Përgatitja e raportit të monitorimit dhe vlerësimit;<br>5. Shpërndarja e informacionit.</td></tr>
<tr><td colspan="10">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="10">– Realizimi i monitorimit të Planit të Përgjithshëm Vendor në fund të çdo viti fiskal, duke analizuar situatën aktuale dhe nivelin e zbatimit të planit. Ky proces do të lehtësojë identifikimin e problemeve, ofrimin e zgjidhjeve dhe matjen e progresit në drejtim të objektivave të përcaktuara..<br>– Kryerja e vlerësimit të ndërmjetëm dhe përfundimtar gjatë periudhës së zbatimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, me qëllim vlerësimin e efektivitetit të ndërhyrjeve dhe rekomandimin e masave për përmirësim të qëndrueshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="5">c) Aktorët e mundshëm</td><td colspan="5">d) Kontributet e mundshme në projekt</td></tr>
<tr><td colspan="5">Bashkia Shkodër<br>Grupet e interesit</td><td colspan="5">Bashkia Shkodër, Donatorë, Programe të BE-së.</td></tr>
<tr><td colspan="10">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet</td><td rowspan="2">Totali (mijë lekë)</td><td colspan="7">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td colspan="2">Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td colspan="2">Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Monitorimi dhe vleresimi i Planit</td><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td></td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td></td><td></td><td colspan="2"></td><td></td><td></td><td colspan="2"></td></tr>
<tr><td colspan="3">f) ) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029</td><td colspan="7">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>Institucioni likuidues: Bashkia Shkodër</td></tr>
</table>

| Nr. 2 | **P.AC141.Q1.O1.A2.** Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | **Funksioni 4:** Çështje ekonomike<br><br>**Programi AC141:** Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Programi Rajonal për Demokracinë Vendore në Ballkanin Perëndimor – Faza 3 (ReLOaD3) është një nismë e financuar nga Bashkimi Evropian (BE) dhe e zbatuar nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP Albania). Ky program përfaqëson vazhdimin e fazave të mëparshme ReLOaD1 dhe ReLOaD2, të cilat janë zbatuar gjatë periudhës 2017–2024, ku Bashkia Shkodër ka qenë një nga partnerët përfitues.
Në kuadër të ReLOaD1, Bashkia Shkodër miratoi me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 69, datë 30.10.2017, Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet UNDP Albania dhe Bashkisë Shkodër, duke pranuar zbatimin e metodologjisë LOD për financimin transparent dhe konkurrues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC). Po ashtu, në fazën ReLOaD2 (2021–2023), bashkia vijoi angazhimin e saj përmes një memorandumi bashkëpunimi të nënshkruar me UNDP Albania.
Faza e tretë e programit – ReLOaD3 do të zbatohet në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor: Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Kosovë, Serbi dhe Shqipëri, dhe do të zgjasë 48 muaj, nga 1 Shkurti 2025 deri më 31 Janar 2029. Në Shqipëri, ReLOaD3 do të mbështesë shtatë bashki bashki partnere nga të cilat dy janë përzgjedhur nga bashkitë që kanë qenë pjesë e fazave të mëparshme të programit. Sipas kritereve të programit, Bashkia Shkodër angazhohet të organizojë tre thirrje publike për projekt-propozime nga OSHC-të:

- Dy thirrjet e para do të financohen përmes një fondi të përbashkët, ku 48% do të mbulohet nga UNDP dhe 52% nga fondet e Bashkisë Shkodër (në një periudhë dyvjeçare).
- Thirrja e tretë dhe e fundit do të financohet tërësisht nga fondet e vetë bashkisë.

Qëllimi i përgjithshëm i programit është të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe të mbështesë procesin e integrimit evropian në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke fuqizuar rolin aktiv të shoqërisë civile në vendimmarrje dhe duke kontribuar në krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar të favorshëm për zhvillimin e saj.

Fushat prioritare për thirrjet publike do të përcaktohen nga Bashkia Shkodër në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, përpara shpalljes së çdo thirrjeje. Të gjitha thirrjet do të zbatohen në përputhje me metodologjinë LOD, e cila miratohet me Vendim të Këshillit Bashkiak, sikurse ka ndodhur edhe në fazat e mëparshme të programit.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi është zbatimi i qasjes në bazë projekti, në mënyrë që bashkitë të realizojnë objektivat e tyre zhvillimore, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Bashkia Shkodër do të organizojë thirrjet publike për organizatat e shoqërisë civile në kuadër të Programit Rajonal për Demokracinë Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD3), duke ndjekur metodologjinë LOD.
2. Përcaktimi i prioritetevetë thirrjeve për projekt-propozime.
3. Lancimi i thirrjes
4. Vlerësimi i projekteve të dorëzuara.
5. Zbatimi dhe Monitorimi i projekteve fituese.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane;
- Përfshirje e shoqërisë civile në vendimarrje;
- Rritje e transparencës me publikun

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër UNDP<br>Albania<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD3)<br>Bashkia Shkodër<br>Programet e BE |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad3) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | 2,300 | | | | 2,300 | |
| | **Shuma** | 2,300 | | | | 2,300 | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Vazhdimi i zbatimit të metodologjisë LOD (ReLOad3) si instrument financiar për forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve. | 4,000 | | | | 4,000 | |
| | **Shuma** | 4,000 | | | | 4,000 | |

| | |
|---|---|
| **f) ) Periudha e zbatimit 2027, 2028** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>**Institucioni likujdues**: Bashkia Shkodër |

<table>
<tr><td>Nr. 3</td><td>P.AC141.Q1.O1.A3.Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj</td><td>Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural</td></tr>
<tr><td colspan="3">a) Përshkrim i shkurtër i projektit:</td></tr>
<tr><td colspan="3">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="3">Bashkëpunimi rajonal dhe koordinimi i ndihmës së huaj përfshin krijimin e mundësive për të forcuar marrëdhëniet dhe bashkëpunimin Bashkia Shkodër, duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit rajonal dhe koordinimit të ndihmës së huaj si faktor thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe social të territorit, ka ndërmarrë një angazhim për të forcuar marrëdhëniet dhe partneritetet me autoritetet lokale dhe rajonale në vend dhe jashtë tij. Ky bashkëpunim synon jo vetëm të optimizojë përdorimin e burimeve financiare dhe të tjera, por edhe të harmonizojë investimet dhe projektet me prioritetet strategjike të zhvillimit vendor, duke krijuar kështu një kuadër të koordinuar dhe efikas për menaxhimin e ndihmës së huaj.<br><br>Në një kontekst ku integrimi në Bashkimin Europian shihet si perspektiva më e mirë dhe më sfiduese e zhvillimit për Bashkinë Shkodër dhe gjithë rajonin, bashkëpunimi rajonal merr një rëndësi të veçantë. Bashkia ka promovuar dhe konsoliduar iniciativa për bashkëpunim të zgjeruar me qytete dhe rajone të tjera, që lidhen me Shkodrën jo vetëm nga aspekti gjeografik, por edhe nga lidhjet historike, kulturore dhe ekonomike që i bashkojnë këto komunitete ndër shekuj. Ky bashkëpunim jo vetëm që nxit shkëmbimin e eksperiencave dhe ideve, por është edhe një mjet i fuqishëm për të tërhequr fonde nga programet ndërkufitare dhe të tjera të financuara nga Bashkimi Europian, duke i shërbyer kështu një zhvillimi ekonomik të balancuar, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm të rajonit.<br><br>Një element i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi është edhe koordinimi i ndihmës së huaj, ku Bashkia Shkodër ka ndërtuar mekanizma efektivë për menaxhimin dhe shpërndarjen e fondeve të huaja në përputhje me prioritetet vendore, duke garantuar që çdo investim të ketë ndikim të dukshëm në zhvillimin ekonomik, përmirësimin e infrastrukturës dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët. Përveç kësaj, Bashkia është angazhuar për mbulimin e shpenzimeve për projektet e shpallura fituese në kuadër të programeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke siguruar kështu realizimin e suksesshëm të tyre brenda afateve dhe me standarde të larta cilësore.<br><br>Një tjetër dimension i rëndësishëm është përfshirja e Bashkisë Shkodër në shoqata dhe rrjete ndërkombëtare, siç janë FAIC dhe Rrjeti i Qyteteve Ballkanike B40, të cilat i ofrojnë mundësi për bashkëpunim të thelluar në fusha të ndryshme si zhvillimi ekonomik, promovimi i trashëgimisë kulturore, mbrojtja e mjedisit dhe shkëmbimi i praktikave më të mira në administratën vendore. Anëtarësimi në këto organizata kërkon përmbushjen e disa detyrimeve financiare, si pagesa e kuotave vjetore, që Bashkia merr përsipër për të siguruar vazhdimësinë e përfitimeve që rrjedhin nga pjesëmarrja aktive në këto rrjete.<br><br>Bashkia Shkodër angazhohetgjithashtu të intensifikojë përpjekjet e saj për të marrë pjesë aktive në programet e Bashkimit Europian, duke marrë pjesë në thirrje si IPA, Interreg ADRION, Horizon Europe, Europe Aid Call for Proposal, IPA Crossborder Shqipëri – Mali i Zi, Programi MED dhe të tjera, me qëllim sigurimin e burimeve financiare që mbështesin zhvillimin ekonomik, infrastrukturor dhe social të rajonit. Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër ka për detyrë të parashikojë në buxhetet e saj vjetore dhe afatmesme fondet e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve të anëtarësimit në shoqata ndërkombëtare, si dhe për mbështetjen financiare të projekteve fituese nga programet ndërkombëtare, duke garantuar një menaxhim transparent, efikas dhe të qëndrueshëm të burimeve financiare në shërbim të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.</td></tr>
<tr><td colspan="3">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Të parashikojë fondin për anëtarësimin në shoqata ndërkombëtare si dhe të parashikojë fondin për mbulimin e shpenzimeve në kuadër të bashkëpunimeve në Programet e Bashkimit Europian për periudhën 2027 – 2029.</td></tr>
<tr><td colspan="3">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">1. Përmbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga anëtarësimi i Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare, përfshirë pagesën e kuotave vjetore dhe shpenzimeve të tjera të përcaktuara nga statutet përkatëse.<br>2. Përmbushja e detyrimeve financiare që lidhen me marrëveshjet e granteve të nënshkruara nga Bashkia Shkodër, në përputhje me legjislacionin dhe rregulloret në fuqi, për të garantuar zbatimin efikas dhe transparent të projekteve të financuara.</td></tr>
<tr><td colspan="3">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="3">– Ngritje e kapaciteteve institucionale për menaxhimin e detyrimeve financiare dhe zbatimin e projekteve të financuara nga grante të ndryshme.<br>– Rritje e numrit të projekteve të financuara.<br>– Përfshirje aktive e Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare, e garantuar përmes pagesës në kohë të kuotave dhe respektimit të kërkesave statutore.<br>– Rritje e transparencës dhe komunikimit me publikun, përmes raportimit të qartë dhe llogaridhënies financiare në lidhje me projektet dhe bashkëpunimet ndërkombëtare.</td></tr>
<tr><td colspan="2">c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)</td><td>d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)</td></tr>
<tr><td colspan="2">Bashkia Shkodër<br><br>Delegacioni i Bashkimit Europian</td><td>Bashkia Shkodër Programet e BE-së Shoqata ndërkombëtare<br>Donator të tjerë</td></tr>
</table>

| e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare. | 200 | | | | 200 | |
| A.2 | Shpenzime të tjera për projektet e financuara nga BE dhe organizata të Tjera | 300 | | | 300 | | |
| A.3 | Mbulimi i shpenzimeve të programuara për udhëtime | 300 | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **800** | | | **600** | **200** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare. | 200 | | | | 200 | |
| A.2 | Shpenzime të tjera për projektet e financuara nga BE dhe organizata të tjera | 300 | | | 300 | | |
| A.3 | Mbulimi i shpenzimeve të programuar për udhëtime | 300 | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **800** | | | **600** | **200** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operativ e | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Vlerë anëtarësimi të Bashkisë Shkodër në shoqata ndërkombëtare. | 200 | | | | 200 | |
| A.2 | Shpenzime të tjera për projektet e financuara nga BE dhe organizata të tjera | 300 | | | 300 | | |
| A.3 | Mbulimi i shpenzimeve të programuar për udhetime | 300 | | | 300 | | |
| | **Shuma** | **800** | | | **600** | **200** | |
| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër | | | | |

| Nr. 4 | **P.AC141.Q1.O1.A4**. Projekti ART for Europe (ARTE) | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër është shpallur fituese e projektit "ARTE – Arti për Europën", i cili është pjesë e programit CERV – Network of Towns, në bashkëpunim me organizatën jofitimprurëse ESCOOP – European Social Cooperative – Cooperativa Sociale Europea (Partneri Lider në projekt). Partner të tjerë në këtë projekt janë Komuna Tuz e Malit të Zi, organizata DESINCOOP (Portugali) dhe organizata ARSIS (Greqi). Projekti synon të bashkojë të rinjtë nga vende të ndryshme për të reflektuar mbi arritjet e BE-së dhe ndikimet pozitive të iniciativave të financuara nga ajo, duke krijuar ndjenjën e unitetit dhe tejkalimin e dallimeve kulturore dhe gjeografike. Përmes eventeve ndërkombëtare dhe takimeve online, projekti do të promovojë shkëmbimin kulturor dhe bashkëpunimin midis të rinjve, duke forcuar ndjenjën e përkatësisë ndaj një trashëgimie të përbashkët evropiane si bazë për të ardhmen. Projekti fokusohet kryesisht tek të rinjtë 18-30 vjeç, të cilët do të jenë në qendër të të gjitha aktiviteteve në bashkëpunim me Qendrën Rinore "Atelie", maturat e shkollave të mesme të qytetit dhe Universitetin "Luigj Gurakuqi".
Qëllimi kryesor i projektit është **forcimi i kapaciteteve institucionale dhe nxitja e** bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, shkollave, organizatave kulturore dhe aktorëve të tjerë lokalë. Projekti e trajton kulturën si një hapësirë ndërveprimi dhe përfshirjeje, ku arti shërben si gjuhë e përbashkët për shprehjen e ndjenjave, përkatësisë dhe identitetit individual e kolektiv. Përmes aktiviteteve ndërdisiplinore dhe pjesëmarrëse, **rinia zë një rol qendror** në zbatimin e projektit, duke u përfshirë në proceset krijuese, edukative dhe bashkëpunuese që lidhen me artin, trashëgiminë dhe qytetarinë aktive. Në këtë mënyrë, projekti mbështet vizionin e Bashkisë Shkodër për të vendosur kulturën dhe krijimtarinë në qendër të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të forcimit të identitetit qytetar. Konkretisht ai mbështetet në 4 shtylla kryesore:

1. **Organizimi i eventeve ndërkombëtare** në secilin nga vendet partnere Itali, Shkodër dhe Portugali ku do të mirëpriten rreth 15 të ftuar.
2. **Trajnime on-line**: Do të zhvillohen para punëtorive lokale dhe do të përfshijnë rreth 150 pjesëmarrës të rinj për 4 trajnime, për të mësuar rreth historisë/procesit të krijimit dhe zgjerimit të Bashkimit Evropian, aktet dhe momentet kryesore dhe më të rëndësishme, prezantimin e praktikave më të mira të bashkëpunimit, mundësitë për të rinjtë për të udhëtuar, studiuar dhe punuar në vende të tjera të BE-së.
3. **Punëtori artistike dhe kulturore vendore** - Në çdo vend partner do të përfshihen grupe të rinjsh për të shprehur artistikisht vizionin e tyre për Evropën, pritshmëritë e tyre që rrjedhin nga të qenit (ose të bëhesh për pjesëmarrësit shqiptarë dhe malazezë) një qytetar evropian për sa i përket rritjes personale, marrëdhënieve sociale, karrierës, etj. Shprehjet artistike do të mbështeten në gjuhë të ndryshme, bazuar në këngë, piktura, shfaqje kërcimi, etj.). Produktet artistike që do të krijohen gjatë punëtorive do të prezantohen në një panair/ekspozitë gjatë ngjarjeve ndërkombëtare. Do të zhvillohen 12 punëtori, çdo muaj do të përfshihen 10 të rinj për secilin workshop në lokacione të ndryshme.
4. **Hartimi dhe nënshkrimi i Deklaratës së Bashkëpunimit** nga të gjitha Bashkitë e përfshira në projekt të pakten 2 vite pas mbarimit të projektit, përmes së cilës ato do të angazhohen për të krijuar një rrjet të qëndrueshëm qytetesh, falë të cilit do të thellojnë dhe intensifikojnë bashkëpunimin mes tyre, duke skicuar një vizion afatgjatë për të ardhmen e integrimit evropian që do të kontribuojë në rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve të tyre në jetën shoqërore, kulturore dhe ekonomike evropiane si dhe në zhvillimin e saj të qëndrueshëm.

Kohëzgjatja e projektit është 24 muaj, duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës nga të gjithë partnerët. Buxheti total i projektit ARTE është 228,050 euro. Buxheti i dedikuar për Bashkinë Shkodër do të jetë 59,005 Euro (5,750,037 Lekë) për të gjithë kohëzgjatjen e Projektit. Kontributi i BE-së mbulon 100% të kostove dhe nuk nevojitet bashkëfinancim.

Transferimi i fondit në buxhetin e Bashkisë Shkodër do të bëhet në dy këste: 60% e buxhetit do të transferohet pas firmosjes së Marrëveshjes së Bashkëpunimit nga Partneri Lider; 40% e buxhetit do të transferohet pas raportimit final dhe njohjes së shpenzimeve. Për këtë arsye, Bashkia Shkodër mori angazhimin që vlerën e këstit të dytë, 2,300,015 lekë, ta parashikonte me kërkesat buxhetore në PBA 2026-2028 dhe ta vendoste në dispozicion të zbatimit të projektit. Në momentin e miratimit të raportit final dhe njohjes së shpenzimeve të projektit nga donatori, kjo shumë do të balancohet me këstin e dytë.
Vlera e TVSH-së është shpenzim që nuk mbulohet me fondet e Bashkimit Evropian. Shpenzimet e TVSH-së do të financohen me fondet e bashkisë, me vlerë **779,697 lekë** të cilat do të alokohen në programin AC141: Mbështetja për Zhvillim Ekonomik Vendor dhe Rural, për shpenzime operative.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi i projektit ARTE është të rrisë pjesëmarrjen e të rinjve në jetën sociale, kulturore dhe ekonomike të Bashkimit Evropian përmes shprehjes artistike. Projekti bashkon të rinj nga vendet anëtare të BE-së dhe nga Shqipëria e Mali i Zi, që janë ende në procesin e anëtarësimit në BE.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Trajnime online, ku të rinjtë do të njihen me historinë e BE-së, procesin e zgjerimit, aktet kryesore dhe shembujt më të mirë të bashkëpunimit midis vendeve anëtare dhe atyre në proces anëtarësimi.
2. Punëtori lokale, që do të zhvillohen në secilin vend partner, ku të rinjtë do të shprehin në mënyrë artistike vizionin e tyre për Evropën dhe çfarë do të thotë për ta të jenë (ose të bëhen) qytetarë evropianë.
3. Evente Ndërkombëtare që do të zhvillohen në Itali, Portugali dhe Shqipëri. Këto ngjarje do të përfshijnë seminare, debate dhe prezantime artistike, duke krijuar hapësira për dialog midis qytetarëve vendas dhe pjesëmarrësve ndërkombëtarë mbi vlerat dhe funksionimin e BE-së.

**b) Rezultatet që prisni**

- Angazhimi i të rinjve në aktivitete evropiane;
- Krijimi i lidhjeve dhe partneriteteve ndërkombëtare;
- Vazhdimësia dhe përforcimi i angazhimit të Bashkisë Shkodër në projekte ndërkombëtare, në përputhje me strategjitë e saj për zhvillim dhe integrim evropian;
- Përhapja e njohurive dhe përvojave të fituara.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Komuniteti<br>Organizatat kulturore<br>Qendra Rinore “Atelie”<br>Shkollat e mesme të qytetit<br>Universiteti “Luigj Gurakuqi” | ESCOOP<br>Bashkia Shkodër<br>Komuna e Tuzit<br>Organizata DESINCOOP (Portugali)<br>Organizata ARSIS (Greqi) |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i Eventit Ndërkombëtar (donatori) | 1,302 | | | 1,302 | | |
| A.2 | Shërbim Ekspertizë e jashtme – Përkthyes (donatori) | 98 | | | 98 | | |
| A.3 | Shpenzime për akomodim dhe udhëtim (donatori) | 1,949 | | | 1,949 | | |
| A.4 | Përmbushja e detyrimeve financiare që rrjedhin nga marrëveshja e grantit **(TVSH-fondet e bashkisë)** | 650 | | | | | 650 |
| | Shuma | **3,999** | | | **3,349** | | **650** |

| **f) Periudha e zbatimit 2027** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr. 5 | **P.AC141.Q1.O1.A5** Bashkia për BE-në | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Shqipëria ndodhet në një moment të rëndesishem të procesit të integrimit evropian, ku hapja e negociatave për anëtarësim përbën një mundësi të rëndësishme për zhvillimin ekonomik, institucional dhe social të vendit. Ky proces kërkon përmbushjen e kritereve të avancuara në fusha të ndryshme, përfshirë administratën publike, qeverisjen vendore, transparencën dhe menaxhimin e fondeve.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 450, datë 26.07.2018, Bashkia Shkodër ka krijuar strukturën e Integrimit Evropian, pjesë e një rrjeti prej 61 bashkive në gjithë Shqipërinë. Kjo strukturë ka për mision të mbështesë dhe të koordinojë institucionet lokale në realizimin e reformave të nevojshme dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga procesi i integrimit në Bashkimin Evropian.

Bashkia Shkodër, përmes sektorit të Integrimit Evropian, ka një rol aktiv në sigurimin e zbatimit efikas të politikave dhe programeve të BE-së në nivel lokal. Ajo menaxhon dhe koordinon përdorimin e fondeve të ndryshme të siguruara nga BE-ja dhe donatorët ndërkombëtarë, duke siguruar transparencë, efikasitet dhe përputhshmëri me standardet evropiane.

Në kuadër të kësaj pune, Bashkia organizon aktivitete të rregullta informuese dhe promovuese, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe njohurive të qytetarëve për procesin e integrimit evropian. Këto aktivitete përfshijnë seminare, punëtori, takime me grupe fokus dhe ngjarje publike, të realizuara në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, shkolla të ndryshme (nga arsimi 9-vjeçar deri te arsimi profesional dhe universiteti “Luigj Gurakuqi”).

Në mes të sfidave të këtij procesi, Bashkia Shkodër siguron angazhimin e të gjitha palëve të interesuara, përfshirë qytetarët, bizneset, institucionet arsimore dhe organizatat joqeveritare, për të përmbushur kërkesat e BE-së në mënyrë transparente dhe efektive. Pjesëmarrja në shoqata ndërkombëtare dhe bashkëpunimi me partnerë evropianë janë gjithashtu komponentë thelbësor në forcimin e kapaciteteve institucionale dhe promovimin e politikave evropiane në nivel lokal.

Kjo qasje e integruar dhe gjithëpërfshirëse e Bashkisë Shkodër synon të mbështesë jo vetëm përmbushjen e detyrimeve ligjore, por edhe ngritjen e një vetëdijeje të gjerë për përfitimet dhe sfidat e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

**ii. Synimi i projektit**

1. Të promovojë parimet e Bashkimit Evropian në nivel vendor;
2. Të krijojë një ndërveprim efektiv midis BE-së, qeverisjes qendrore dhe zyrës së çështjeve të BE -së në secilën Bashki në Shqipëri.
3. Të rrisë njohuritë për IPA-n si dhe fondet e tjera kryesore të BE-së të disponueshme për bashkitë dhe qytetarët Shqiptarë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Organizimi i fushatave informuese mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian.
- Shfrytëzimi i kanaleve të ndryshme promovuese për të arritur audiencën më të gjerë të mundshme.
- Bashkëpunimi me organizata të shoqërisë civile, institucione arsimore dhe aktorë të tjerë lokalë për realizimin e fushatave.
- Organizimi i sesioneve informuese dhe edukative për qytetarët lidhur me fondet dhe mundësitë e financimit nga BE-ja.

**b) Rezultatet që prisni**

- Përmirësim i njohurive dhe ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe aktorëve lokalë mbi politikat, programet dhe projektet e Bashkimit Evropian, si rezultat i fushatave informuese të organizuara.
- Rritje e audiencës dhe përfshirjes së publikut përmes shfrytëzimit të kanaleve të ndryshme promovuese.
- Forcim i bashkëpunimit midis Bashkisë Shkodër, organizatave të shoqërisë civile, institucioneve arsimore dhe aktorëve lokalë, duke krijuar një rrjet më të fortë për promovimin e parimeve të BE-së.
- Rritje e njohurive për fondet dhe mundësitë e financimit nga BE-ja, duke rritur kështu kapacitetet e qytetarëve dhe institucioneve për të përfituar nga këto fonde.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian | Bashkia Shkodër Programet e<br>BE-së Donator të tjerë |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare. | 400 | | | 400 | | |
| | **Shuma** | **400** | | | **400** | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: |
|---|---|---|

| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare. | 500 | | | 500 | | |
| | Shuma | 500 | | | 500 | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve promovuese të lidhura me festat ndërkombëtare. | 500 | | | 500 | | |
| | **Shuma** | **500** | | | **500** | | |
| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>**Institucioni likuidues:** Bashkia Shkodër | | | | | |

| Nr. 6 | **P.AC141.Q1.O1.A6** Diaspora dhe migracioni | **Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural** |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër është e angazhuar në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe përfshirës për të gjithë qytetarët e saj, përfshirë edhe emigrantët që rikthehen dhe komunitetin e diasporës. Një lidhje e fortë mes banorëve vendës dhe atyre jashtë vendit përbën një aset të çmuar për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të rajonit. Për këtë arsye, është e domosdoshme të ndërmerren masa të koordinuara dhe të ofrohet mbështetje e plotë për ri-integrimin e emigrantëve, si dhe të krijohen mundësi për diasporën që të angazhohet aktivisht në jetën dhe zhvillimin e komunitetit lokal. Informimi i saktë dhe bashkëpunimi me institucionet vendore janë hapa kyç për arritjen e këtyre qëllimeve.

Në kuadër të angazhimit të Bashkisë Shkodër për të promovuar migracionin e sigurt dhe të informuar, një ndër objektivat kryesorë është organizimi i sesioneve informuese, të cilat synojnë të ndihmojnë qytetarët që planifikojnë të migrojnë në mënyrë të rregullt, si dhe ata që janë në proces kthimi. Këto sesione nuk janë vetëm takime informuese, por edhe shpërndarje e materialeve praktike dhe udhëzuese ku qytetarët do të kenë mundësinë të mësojnë hapat që duhet të ndjekin për të migruar në mënyrë të ligjshme dhe të sigurt; të kuptojnë më mirë rreziqet e migracionit të parregullt; të njihen me mundësitë formale për punësim, studim apo bashkim familjar në vendet pritëse; të marrin informacion për mbështetjen që ofrohet nga institucionet vendore dhe ato kombëtare në këtë proces.
Për të rritur ndikimin dhe shtrirjen e këtij informacioni, do të prodhohen gjithashtu video promocionale dhe informuese, të cilat do të shpërndahen në rrjetet sociale, faqen zyrtare të Bashkisë dhe media të tjera lokale.

Për më tepër, në kuadër të projektit për Forcimin e kapaciteteve institucionale vendore mbi migracionin në Shqipëri, i cili po zbatohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin, Misioni në Shqipëri (IOM), në bashkëpunim me Bashkinë Shkodër, është planifikuar të realizohet një seri episodësh podcast me fokus te emigrantët e rikthyer në Shkodër. Ky podcast do të sjellë rrëfime personale, ku të rikthyerit do të ndajnë eksperiencat e tyre të migrimit dhe kthimit, sfidat që kanë përballuar në procesin e integrimit dhe ri-integrimit, suksaset që kanë arritur dhe mënyrat se si i kanë kapërcyer vështirësitë, si dhe marrëdhënien e tyre me institucionet vendore pas rikthimit. Qëllimi i këtij podcast-i është të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për migracionin e rregullt, duke ofruar histori reale që shërbejnë si shembuj frymëzues dhe paralajmërues njëkohësisht; të ofrojë informacion të dobishëm mbi politikat dhe shërbimet për ri-integrim, në mënyrë që dëgjuesit të kuptojnë më mirë se cilat janë të drejtat, mbështetjet dhe rrugët e ligjshme që mund të ndjekin nëse vendosin të rikthehen ose të ndihmojnë të tjerët të rikthehen.

Për të ndërtuar një qasje sa më gjithëpërfshirëse dhe efektive ndaj çështjeve të migracionit dhe ri-integrimit, Bashkia Shkodër ka vijuar me ndërmarrjen e nismës për organizimin e takimeve të rregullta koordinuese me institucionet vendore dhe aktorë të tjerë lokalë. Këto takime nuk janë thjesht formale, por shndërrohen në takime për të bashkëpunuar dhe për të shkëmbyer ide ku përfaqësues të sektorëve të ndryshëm diskutojnë hapur sfidat, nevojat dhe rrugët konkrete për të përmirësuar mbështetjen për emigrantët e rikthyer dhe për të forcuar lidhjet me diasporën.

**ii. Synimi i projektit**

Të rrisë njohuritë mbi politikat e Bashkisë Shkodër në lidhje me migracionin e rregullt, migracionin e kthimit dhe diasporën.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Bashkia Shkodër do të sigurojë informimin e publikut dhe veçanërisht grupet e tjera të interesit për politikat e saj në lidhje me çështjet e migracionit dhe diasporës.
- Sesione informuese për migrimin e rregullt.
- Promovimi i modeleve të suksesit të kthyer nga Diaspora.
- Promovimi i profesionistëve të fushave të ndryshme të suksesshem në Diasporë.

**b) Rezultatet që prisni**

- Informimi i publikut në lidhje me politikat vendore për çështjet e migracionit dhe diasporës;
- Ngritje e kapaciteteve institucionale;
- Rritje e transparencës me publikun.

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Delegacioni i Bashkimit Europian Agjensia për diasporen | Bashkia Shkodër Programet e BE-së<br>Shoqata dhe organizata për migracionin dhe diasporën<br>Organizata ndërkombëtare. |

| e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii) | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën. | 500 | | | 500 | | |
| | **Shuma** | **500** | | | **500** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën. | 600 | | | 600 | | |
| | **Shuma** | **600** | | | **600** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizim i aktiviteteve informuese/ngjarjeve për publikun dhe grupet e tjera të interesit në lidhje me migracionin dhe diasporën. | 600 | | | 600 | | |
| | **Shuma** | **600** | | | **600** | | |

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.7** | **P.AC141.Q1.O2.A1** Bashkëpunimi me Zonën e Përmirësimit të Biznesit në Shkodër. | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër, në partneritet me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF), vazhdon përpjekjet për të përmirësuar klimën e biznesit përgjatë rrugëve “13 Dhjetori”, “28 Nëntori” dhe “Kolë Idromeno”. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë organizuar aktivitete kulturore dhe argëtuese, disa prej tyre në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë, si dhe është ofruar konsulencë profesionale për bizneset lokale, me qëllim zhvillimin e qëndrueshëm dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve. Si pasojë e këtyre veprimeve, është vërejtur një përmirësim i dukshëm në standardet e shërbimit të ofruar nga bizneset e zonës.

Qëllimi kryesor i këtij bashkëpunimi mbetet forcimi i bizneseve të vogla dhe transformimi i kësaj zone në një destinacion tërheqës për vizitorët dhe komunitetin lokal. Marrëveshja me AADF nuk është rinovuar ende, pasi po kryhen ndryshime në statutin e Shoqatës së Bizneseve, në përputhje me ligjin nr. 63/2020 "Për Përmirësimin e Zonave të Biznesit (BID)". Aktualisht marrëveshja e re është në proces shqyrtimi dhe pritet nënshkrimi zyrtar, që do të mundësojë fillimin e fazës së ardhshme të projektit.

Në pritje të këtij hapi, të dyja palët mbeten të përkushtuara për të vazhduar bashkëpunimin dhe për të avancuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe përmirësimin e mëtejshëm të kësaj zone strategjike të qytetit.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi kryesor i bashkëpunimit është që të sigurojë një zonë më të pastër, më të sigurtë dhe më tërheqëse duke synuar sigurimin e burimeve të nevojshme për financimin e programeve dhe shërbimeve publike shtesë për t’iu përshtatur nevojave të biznesit duke krijuar
një zonë biznesi që ka aftësi të konkurrojë përmes organizimit të ngjarjeve kulturore, argëtuese, sensibilizuese me qëllim tërheqjen e kalimtarëve të rregullt si dhe turisteve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Bashkia Shkodër do të mbështesë me mjete financiare nëpërmjet transferimit të ardhurave, nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës sipas marrëveshjes së bashkëpunimit të miratuar me VKB, nr. 13, datë 12.03.2012.

**b) Rezultatet që prisni**

- Rishikimi dhe përditësimi i mekanizmit të mbështetjes financiare në përputhje me kuadrin e ri ligjor.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër AADF<br>BID Shkodër | Bashkia Shkodër |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër,nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (000 lek) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | | | | | | |
| **Shuma** | | | | | | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (000 lek) | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Transferimi i të ardhurave nga tarifat që mblidhen nga Bashkia Shkodër, nga bizneset anëtare të shoqatës, të përcaktuara sipas listës së aprovuar. | | | | | | |

| Nr. 8 | **P.AC141.Q1.O2.A2.** Mbështetje për bizneset Agro | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër e konsideron njohjen dhe promovimin e potencialeve të territorit si një pjesë të rëndësishme të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. Pasuritë natyrore, kulturore dhe traditat e prodhimit vendor përbëjnë një bazë të fortë për të ndërtuar një ekonomi të qëndrueshme, të lidhur ngushtë me identitetin dhe resurset e zonës.
Falë vendndodhjes strategjike dhe burimeve të shumta që ofron, nga fushat pjellore te zonat malore, nga liqeni i Shkodrës te trashëgimia kulturore, territori ka potencial të lartë për zhvillim në fusha si bujqësia, blegtoria, peshkimi, agropërpunimi dhe artizanati. Produktet lokale si vera, vaji i ullirit, ushqimet e përpunuara dhe punimet artizanale janë shembuj konkretë të pasurisë dhe traditës që mund të përkthehen në rritje ekonomike dhe punësim.

Një ndër sektorët me potencial të lartë zhvillimi është agropërpunimi – një hallkë e rëndësishme që lidh prodhimin bujqësor e blegtoral me tregun, duke krijuar produkte me vlerë të shtuar dhe duke shtuar mundësi për punësim, sidomos në zonat rurale. Ky sektor, megjithatë, përballet me sfida të rëndësishme, si mungesa e teknologjisë moderne, nevoja për certifikim e standardizim, mungesë kapacitetesh menaxhuese dhe promovim të pamjaftueshëm të markave vendase në tregje më të gjera.

Për të përkrahur këtë potencial, Bashkia Shkodër do të organizojë aktivitete promovuese në njësitë administrative, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit për vlerat vendase, prezantimin e produkteve tradicionale dhe nxitjen e bashkëpunimit mes komunitetit, bizneseve dhe institucioneve. Këto veprimtari synojnë të lidhin ngushtë zhvillimin ekonomik me identitetin lokal dhe të hapin rrugë për investime të reja.
Këto veprimtari synojnë jo vetëm të promovojnë pasuritë që zona ofron, por edhe të nxisin përdorimin e qëndrueshëm të tyre, përmes lidhjes së drejtpërdrejtë me zhvillimin ekonomik dhe social. Ato gjithashtu shërbejnë si platforma të rëndësishme ndërgjegjësimi për rëndësinë e ruajtjes së traditës dhe identitetit lokal, duke i lidhur ato me nevojat e tregut dhe me mundësitë reale për rritje.
Në këtë kuadër, Bashkia Shkodër mbetet e angazhuar të krijojë kushte më të favorshme për zhvillimin e bizneseve vendase, përmes mbështetjes institucionale, përfshirjes së komunitetit dhe ndërveprimit të vazhdueshëm me të gjithë aktorët që kontribuojnë në zhvillimin e territorit.

**ii. Synimi i projektit**

Ky projekt synon rritjen e kapaciteteve të fermereve /sipermarrësve të rinj, promovimin e sipermarrjeve rinore Agro si dhe produkteve vendase me qellim zhvillimin e qendrueshem ekonomik të njësive administrative të Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Organizim i aktiviteteve promovuese ne njësitë administrative
2. Krijimi i bashkëpunimeve me aktorët lokalë;
3. Ndertimi i rrjetit te fermereve te rinj nga njesi te ndryshme administrative;
4. Trajnim për bizneset dhe prodhuesit lokalë
5. Sesion informues mbi funksionimin e rrjetëzimit (ndërveprimi), rëndësia e përfshirjes në rrjetin e fermerëve;
6. Hartimi i nje plani veprimi komunikimi që do të shërbejë për promovimin e aktiviteteve.

**b) Rezultatet që prisni**

- Rritje e vlerësimit të produkteve vendase;
- Zhvillim i tregjeve lokale dhe rritje e mundësive për shitje
- Rritje e të ardhurave në zonat rurale
- Rritja e kapaciteteve te sipërmarrësve të rinj;
- Numri i nismave rinore të mbështetura në sektorin Agro

| **c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen)** | **d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.)** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër Dhoma e<br>Tregtisë Biznese<br>Prodhuesish<br>Shoqata që operojnë në këtë fushë Banorët e Nj.<br>Administrative | Bashkia Shkodër<br>Donatorë |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurim e | Operative | Transferim e | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktiviteteve për mbështetje të iniciativave të bineseve në sektorin agro | 2,000 | | | 2,000 | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | |
| | Shuma | **2,000** | | | **2,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurim e | Operative | Transferim e | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktiviteteve për mbështetje të iniciativave të bineseve në sektorin agro | 2,000 | | | 2,000 | | |
| | **Shuma** | **2,000** | | | **2,000** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurim e | Operative | Transferim e | Kapitale |
| A.1 | Organizimi i aktiviteteve për mbështetje të iniciativave të bineseve në sektorin agro | 2,000 | | | 2,000 | | |
| | **Shuma** | **2,000** | | | **2,000** | | |

| | |
|---|---|
| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër |

| Nr. 9 | **P.AC141.Q1.O2.A3.** Skeme granti per biznese inovative | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Zbatimi i politikave vendore për mbështetjen e bizneseve dhe nxitjen e sipërmarrjes përbën një prioritet strategjik për Bashkinë Shkodër. Rritja e kapaciteteve të bizneseve lokale dhe krijimi i mundësive të reja për të rinjtë janë elementë kyç për zhvillimin e një ekonomie të fortë, konkurruese dhe inovative. Në këtë kontekst, Bashkia Shkodër synon të forcojë bashkëpunimin me sektorin privat, duke u orientuar drejt zhvillimit ekonomik bazuar në një skemë granti për financimin e individëve mbi moshën 18 vjeç, rezidentë në Bashkinë Shkodër, të cilët kanë një ide biznesi apo kanë një biznes ekzistues të vogël ose të mesëm të cilin kanë dëshirë ta avancojnë në procese të reja kryesisht teknologjike dhe novatore.

**Skema e grantit për bizneset inovative,** financohet nga burimet e veta të buxhetit vendor dhe përfaqëson një praktikë të mirë të bashkëpunimit midis pushtetit vendor dhe sektorit privat, duke krijuar një qasje të qëndrueshme dhe efektive në mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal. Procesi i zbatimit të skemës bazohet në parimet e transparencës, konkurrencës së barabartë dhe përzgjedhjes me meritokraci. Thirrja për aplikime publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe qëndron e hapur për të paktën katër javë nga data e shpalljes, duke i dhënë mundësi çdo aplikanti të përgatitet dhe të dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm sipas Udhëzuesit të publikuar. Aplikantët përzgjidhen nëpërmjet një procesi konkurrues, ku vlerësohen idetë dhe planet e biznesit më të mira, fitimprurëse, që garantojnë rezultate të qëndrueshme dhe me ndikim ekonomik e social në komunitet. Skema zbatohet në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.

Bashkia Shkodër ka shpallur thirrjen e parë në kuadër të kësaj skeme në vitin 2024, me temë:
**"Skemë granti për të rinjtë në mbështetje të zhvillimit të iniciativave ekonomike lokale duke ruajtur një qasje miqësore ndaj mjedisit."**

Thirrja është shpallur në faqen zyrtare të Bashkisë Shkodër dhe ka patur 6 fitues. Gjatë kohëzgjatjes së thirrjes janë organizuar një sërë aktivitetesh informuese, me qellim njohjen e aplikuesve të mundshëm me kriteret e kësaj skeme, mënyrën e aplikimit, etj. Kjo mbështetje financiare është një mundësi e mirë për sipërmarrësit që duan të angazhohen në zhvillimin e zgjidhjeve që stimulojnë rritjen ekonomike.
Individët të cilët do të shpallen fitues, duhet të regjistrohen si entitete ligjore përpara nënshkrimit të kontratës dhe disbursimit të fondeve, duke garantuar kështu zbatimin e rregullt dhe transparent të mbështetjes financiare. Përgjatë kohëzgjatjes së implementimit të projekt-ideve fituese, grupi i monitorimit i ngritur nga Bashkia Shkodër, do të ketë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e të gjithë procesit që nga nënshkrimi i kontratës, raporteve periodike, sigurimit të produkteve dhe rezultateve të pritshme nga secili nga përfituesit.

Kjo skemë përbën një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit ekonomik të të rinjve dhe rritjes së sipërmarrjeve lokale që kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të Bashkisë Shkodër, duke krijuar mundësi reale për angazhim dhe punësim për brezin e ri. Përmes kësaj nisme, Bashkia synon të nxisë të rinjtë të investojnë talentin, idetë dhe energjinë e tyre në qytetin ku jetojnë, duke e parë Shkodrën si një vend me potencial për zhvillim e prosperitet, dhe njëkohësisht si një instrument të rëndësishëm për parandalimin e emigracionit tek të rinjtë.

**ii. Synimi i projektit**

Promovimi i zhvillimit të qendrueshëm ekonomik nëpërmjet eko-inovacionit.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Hartimi dhe miratimi i paketës së thirrjes për ide të gjelberta nga Këshilli Bashkiak Shkodër, në zbatim të ligjit për ndihmen shtetërore 9374, datë 21.04.2005, i ndryshuar.
2. Shpallja e thirrjes dhe përzgjedhja e ideve fituesve.
3. Lidhja e kontrates, zbatimi dhe monitorimi i projekteve fituese.

**b) Rezultatet që prisni**

- Ngritje e kapaciteteve institucionale.
- Përmirësim i shërbimeve me standarde europiane.
- Nxitja e ekonomisë rrethore dhe mundësive të reja të zhvillimit.

| c) Aktorët e mundshëm (grupet që lidhen me projektin dhe që ndikohen) | d) Kontributet e mundshme në projekt (kush do të kontribuojë për këtë projekt, financiarisht, etj.) |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e Financave dhe ekonomisë Universiteti Luigj Gurakuqi | Bashkia Shkodër<br>Institucione financiare<br>Programet e BE-së<br>Organizatave ndërkombëtare. |

**e) Shpenzimet e llogaritura (për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Nga kjo |
|---|---|---|

| | | Totali (mijë lekë | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide/biznese inovative | 300 | | | 300 | | |
| A.2 | Ekspert të jashtëm për mentorim (1 person x 200 mijë) | 200 | | | 200 | | |
| A.3 | Grant për mbështetjen e ideve /bizneseve inovative | 2,500 | | | | 2,500 | |
| | **Shuma** | **3,000** | | | **500** | **2,500** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative | 300 | | | 300 | | |
| A.2 | Ekspert të jashtëm për mentorim (1 person x 200 mijë) | 200 | | | 200 | | |
| A.3 | Grant për mbështetjen e ideve/ bizneseve inovative | 2,500 | | | | 2,500 | |
| | **Shuma** | **3,000** | | | **500** | **2,500** | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë | Nga kjo | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Organizimi dhe shpallja e thirrjes për ide eko-inovative | 300 | | | 300 | | |
| A.2 | Ekspertë të jashtëm për mentorimi (1 person x 200 mijë) | 200 | | | 200 | | |
| A.3 | Grant për mbështetjen e ideve /bizneseve inovative | 2,500 | | | | 2,500 | |
| | **Shuma** | **3,000** | | | **500** | **2,500** | |
| **f) f) ) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | | | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br><br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br><br>**Institucioni likuidues**: Bashkia Shkodër | | | | |

| Nr.10 | **P.AC141.Q2.O1.A1**<br>Mirëmbajtje e tregjeve ekzistuese | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër e konsideron prioritet ngritjen e tregjeve dhe krijimin e një rrjeti të konsoliduar të tyre, për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesës së konsumatorëve dhe ofertës së tregtarëve, në përputhje me standardet bashkëkohore. Një infrastrukturë funksionale dhe moderne jo vetëm që nxit investimet, por edhe lehtëson lidhjen e drejtpërdrejtë mes prodhuesit dhe konsumatorit, duke zgjeruar kështu përmasat dhe ndikimin e tregut lokal. Për këtë arsye, tregu duhet të konceptohet jo vetëm si një hapësirë tregtimi, por edhe si një qendër sociale, ekonomike dhe komunitare, që gjallëron jetën urbane dhe mbështet zhvillimin e qëndrueshëm.

Në vijim është parashikuar përmirësimi i infrastrukturës dhe shërbimeve në këto hapësira. Ndërhyrjet përfshijnë aktivitete të tilla si pastrimi, përmirësimi i aksesit në tregje, riparime të infrastrukturës, tezgave dhe banakëve, lyerje, mirëmbajtje logjistike dhe sanitare, si edhe sigurimi i shërbimeve të nevojshme të elektricitetit dhe ujit. Gjithashtu, përfshihen riparime në ambientet e magazinimit të mallrave. Qëllimi është të sigurohet një ambient i pastër dhe tërheqës, i cili nxit aktivitetin ekonomik dhe mbështet zhvillimin e komunitetit lokal. Përmes këtij angazhimi, Bashkia Shkodër synon të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve dhe frekuentimit të tregjeve. Aktualisht Bashkia Shkodër, në funksion të organizimit dhe menaxhimit të tregjeve publike, ka të krijuara dy subjekte me formë juridike shoqëri aksionare (sh.a):

- Scodrinon Sh.a: i cili menaxhon Tregun e Rusit, dhe Godinën e Markatës së Rusit, në bazë të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 74, datë 19/12/2024.
- Tregu i Shumicës Fruta – Perime Sh.a. që nga viti 2023 me VKM nr. 432 datë 19.7.2023 "Transferimin e Pronësisë së 67,21% të aksioneve të shoqërisë "Tregu i shitjes me Shumicë Fruta – Perime" sh.a. Shkodër, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë tek Bashkia Shkodër". Ky treg ka të instaluar një matës të përgjithshëm të energjisë elektrike i regjistruar në emër të Tregu i shitjes me shumicë fruta – perime sh.a. Gjatë viteve, ky treg ka pasur përdorues të ndryshëm, por mungesa e matësve individualë ka bërë të pamundur ndarjen e detyrimeve për energjinë elektrike sipas konsumit mujor të secilit përdorues. Kjo situatë ka krijuar vështirësi të vazhdueshme në balancimin financiar të shoqërisë Sh.a. Për këtë arsye, është planifikuar instalimi i 15 matësve individualë për përdoruesit e njësive tregtare në këtë treg.

Përveç dy subjekteve ekzistuese, Bashkia Shkodër ka në plan edhe krijimin e tregjeve të reja, në përputhje me kërkesat e rritura të komunitetit dhe planifikimin urban afatgjatë. Tregjet e reja do të ndërtohen mbi të njëjtat parime: infrastrukturë moderne, menaxhim eficient, transparencë financiare dhe fokus në përfshirjen e prodhuesve dhe konsumatorëve lokalë. Ky proces mbetet pjesë integrale e politikave të zhvillimit ekonomik lokal, që synojnë rigjallërimin e qendrave urbane, përmirësimin e shërbimeve dhe forcimin e partneritetit mes institucioneve dhe komunitetit.

**ii. Synimi i projektit**

Një nga synimet e ketij programi është të krijojë një ambjent funksional dhe tërheqës për tregtarët dhe konsumatorët, duke kontribuar në përmirësimin e higjenës dhe duke promovuar produktet lokale.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

1. Vlerësimi i kërkesës për mirëmbajtjen e tregjeve
2. Ofrimi i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe riparimeve të nevojshme për të siguruar qëndrueshmërinë e kushteve të tregtimit.

**b) Rezultatet që prisni**

Tregje operative që përmbushin standardet dhe sigurojnë kushte të përshtatshme për veprimtari tregtare te favorshme.

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Fermerët | Bashkia shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali(mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Shërbime të mirëmbajtjes për ruajtjen dhe qëndrushmërinë e kushteve të tregtimit | | | | | | |
| A.2 | Instalimi i 15 matësve individual për përdoruesit e njësive tregtare Tregu i Shumicës Fruta – Perime Sh.a. | | | | | | |
| A.3 | Mbështetje financiare për Sh.a. Skodrinon, për Tregun Rus | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e Përmirësimit të Klimës së Biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve Drejtoria e Shërbimeve Publike<br>Institucioni likujdues: **Bashkia Shkodër** |
|---|---|

| Nr.11 | **P.AC141.Q2.O1.A2.**<br>Tregu i produkteve bujqësore Velipojë | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Velipoja përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme të turizmit bregdetar në Bashkinë Shkodër dhe ka njohur rritje të ndjeshme demografike e ekonomike, veçanërisht gjatë sezonit turistik, duke u shndërruar në një destinacion tërheqës për pushues vendas dhe të huaj. Megjithatë, infrastruktura tregtare në Velipojë mbetet ende e kufizuar dhe shpesh nuk plotëson standardet e nevojshme të pastërtisë, higjienës dhe shërbimeve për qytetarët dhe vizitorët, çka nënvizon domosdoshmërinë për zhvillimin e tregjeve lokale funksionale dhe të standardizuara në këtë zonë.

Për shkak të fluksit jashtëzakonisht të lartë të vizitorëve dhe turistëve gjatë sezonit veror në Velipojë, ndërtimi i tregjeve lokale funksionale dhe standardizuara bëhet një prioritet urgjent. Sipas të dhënave zyrtare/raportimeve lokale, çdo fundjavë e pikut të sezonit përkon me rreth 250 000 pushues që frekuentojnë zonën turistike. Kjo sjell një shtim të konsiderueshëm të konsumit të produkteve ushqimore, artizanale dhe të shërbimeve tregtare në territor. Në të njëjtën kohë, popullsia e përhershme në Velipojë është rritur në mënyrë të ndjeshme gjatë dekadave të fundit. Kjo rritje demografike tregon gjithashtu një domosdoshmëri për shërbime lokale me cilësi dhe një infrastrukturë të qëndrueshme tregtare për komunitetin që jeton gjatë gjithë vitit.

Duke marrë parasysh konsumin e shtuar të produkteve si dhe nevojën për një mjedis të përshtatshëm për tregtim, nevoja për ndërtimin e tregut është shumë e madhe. Rrjeti i tregtisë në Bashkinë Shkodër duhet të plotësohet me tregjet lokale të shpërndara në njësitë administrative, veçanërisht në zonat turistike dhe bujqësore të populluara si Shkodra (të paktën nga një treg për njësi) dhe Velipoja (2 tregje të cilat do të funksionojnë gjatë periudhës së verës).

Këto tregje do të shërbejnë si qendra të integruara ekonomike dhe sociale, ku do të promovohet koncepti “nga tregu në tavolinë – 0 km”, duke nxitur tregtimin e produkteve vendase bujqësore, peshkimit dhe akuakulturës, si dhe do të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë lokale. Hapësirat e dedikuara nuk do të jenë vetëm hapësira tregtimi, por edhe hapësira sociale e rekreative, të projektuara për të ofruar shërbime moderne, siguri ushqimore dhe kushte optimale për shitësit e blerësit. Krijimi i tregut të formalizuar është një hap i nevojshëm që duhet ndërmarrë në mënyrë që të kemi një integrim dhe standartizim të ekonomive rurale me sistemin ekonomik të bashkisë Shkodër,ku edhe shërbimi dhe kontrolli nga ana e institucioneve (p.sh AKU) është më efektiv dhe konsumatori ndihet më i mbrojtur.

Zhvillimi i kësaj infrastrukture kërkon një proces të planifikuar me kujdes, i bazuar në studime të detajuara teknike dhe financiare, si dhe në pjesëmarrjen aktive të aktorëve lokalë – përfshirë fermerët, tregtarët, transportuesit, punonjësit dhe institucionet vendore.
Ky investim synon të formalizojë aktivitetet ekonomike lokale, të rrisë efektivitetin e mbikëqyrjes dhe kontrollit institucional, si dhe të integrojë ekonomitë rurale me sistemin ekonomik të Bashkisë Shkodër, duke kontribuar në krijimin e një modeli të qëndrueshëm zhvillimi ekonomik dhe social për zonat turistike dhe bujqësore të territorit.

**ii. Synimi i projektit**

Formalizimi i tregtimit te shitjes me pakicë në njësinë administrative Velipojë dhe sigurimi i kushteve te pershtatshme te tregtimit: Mbështetja prodhuesve vendas te bujqësisë, peshkimit dhe akuakulturës, rritja e tregtimit të produkteve si dhe siguria ushqimore.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Studim i fizibilitetit të investimit
2. Aktivitete parapërgatitore (Projekti Teknik)
3. Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë
4. Rregullim i ambjenteve të tregjeve
5. Ngritja e ambjenteve për trajtimin e mbetjeve organike
6. Ndërtimi i infrastrukturës mbështetëse.

**b) Rezultatet që prisni**

Ndërtim i një tregu të ri të shitjes me pakicë të produkteve lokale të njësisë administrative Velipojë

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Ministria e bujqësisë, Azhbr Universiteti i Shkodër FSHZH | Bashkia Shkoder |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hartimi i projektit teknik | | | | | | |
| A.2 | Ndërtimi i tregut të shitjes Velipojë | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e planifikimit strategjik dhe përmirësimit të klimës së biznesit Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |
|---|---|

| Nr.12 | **P.AC141.Q2.O1.A3** Ndërtimi i tregut multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrim i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Bashkia Shkodër përfaqëson një nga zonat më të rëndësishme në Shqipëri përsa i përket prodhimit bujqësor dhe blegtoral. Bujqësia, blegtoria dhe pylltaria përbëjnë sektorët kryesorë në përdorimin e tokës dhe menaxhimin e burimeve natyrore në zonat rurale të kësaj bashkie. Kjo pasuri natyrore dhe prodhuese paraqet një potencial të madh për zhvillim ekonomik dhe kërkon vëmendje nga shumë këndvështrime. Një rëndësi të veçantë zënë produktet agropërpunuese.

Nga vlerësimi i interesit dhe analizat e fizibilitetit për ndërtimin e tregjeve, ka dalë e domosdoshme ngritja e strukturave të reja për tregtimin me pakicë të produkteve bujqësore dhe blegtorale. Aktualisht, fermerë dhe tregtarë që ofrojnë produktet e tyre sezonale shpesh operojnë në kushte të papërshtatshme, pa një vend të qëndrueshëm dhe të organizuar. Kërkesat e tyre për hapësira të përshtatshme tregtimi janë të shumta dhe të përligjura. Në territorin e qytetit të Shkodrës janë evidentuar fermerë dhe tregtarë informalë që kanë nevojë për sistemim në hapësira të përshtatshme. Po ashtu, në Njësitë Administrative të Bashkisë Shkodër ekziston një kërkesë e vazhdueshme për ngritjen e tregjeve për shitjen e produkteve vendase. Ndërtimi i një Tregu multifunksional të produkteve agro-ushqimore lokale, qoftë në qytet apo në njësitë administrative, si një strukturë moderne dhe shumëfunksionale, që respekton ambientin dhe është në përputhje me standardet e sigurisë ushqimore, do të ndikojë ndjeshëm në rritjen e potencialit prodhues të sektorit bujqësor. Megjithatë, ndërtimi i tregjeve të reja është një proces kompleks që kërkon investime të konsiderueshme kapitale dhe duhet të bazohet në studime të mirëfillta mbi nevojat konkrete të tregut dhe një vlerësim të plotë financiar.

Duke qënë të vetëdishëm se zhvillimi i infrastrukturës urbane në vend sëbashku me komponentë të tjerë të infrastrukturës së biznesit, shërbejnë si parakushte për perdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore vendore, Bashkia Shkodër planifikon ndërtimi i një tregu për shitjen me pakicë të produkteve lokale agroushqimore. Kjo nismë synon zhvillimin e një tregtie të formalizuar dhe të standardizuar, ku shërbimet dhe kontrolli institucional të jenë më efikase. Krijimi i këtyre tregjeve do të ndihmojë në integrimin e ekonomisë informale me sistemin ekonomik zyrtar të Bashkisë Shkodër, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm dhe të strukturuar të zonës.

ii. **Synimi i projektit**

Synimi i projektit është ndërtimi i një tregu agroushqimor të standardizuar në Bashkinë Shkodër, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik lokal dhe përmirësimin e kushteve të tregtimit, promovimin e produkteve vendore dhe garantimin e sigurisë ushqimore.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Analiza e prodhimit aktual dhe të ardhshëm të fruta-perimeve;
2. Analiza e fluksit të tregtimit të prodhimeve ekzistuese;
3. Analiza e infrastrukturës ekzistuese të tregjeve dhe evidentimi i nevojës;
4. Hartimi i projektit teknik për ndertimin e tregut të shitjes me pakicë;
5. Ndërtimi i tregut në të shitjes me pakicë;
6. Mbikqyrje;
7. Kolaudimi.

**b) Rezultatet që prisni**

1) Krijimi i një tregu agroushqimor të standardizuar;
2) Krijimi i kushteve të qëndrueshme dhe të përshtatshme për fermerët dhe tregtarët lokalë;
3) Zhvillimi i një ekonomie lokale më konkurruese dhe të qëndrueshme;
4) Rritje e sigurisë ushqimore;
5) Promovim i produktit vendas si një atraksion ekonomik dhe kulturor që kontribuon në zhvillimin ekonomik rajonal.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër | Bashkia Shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Projektimi | | | | | | |
| A.2 | Ndërtimi, mbikqyrja dhe kolaudimi i Tregut | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br><br>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër |
|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| **Nr.13** | **P.AC141.Q2.O1.A4** Rikualifikimi i godinës së Merkatës Rus | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Në vijim të shkresës nr. 5807 prot. datë 3.9.2024 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural “Mbi Financimin e Tregjeve” Bashkia Shkodër ka realizuar aplikimin nr.1848 prot. datë 16.09.2024 pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për Rikualifikim të godinës së merkatos Rus dhe është përzgjedhur për financim në kuadër të zbatimit të aktit normativ nr. 5 datë 19.12.2024 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, të udhëzimit të Ministrit të financave nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” të ndryshuar, sipas shkresës së Ministrisë së Financave nr. 17526/3 Prot. dt. 23.12.2024, “Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.5, datë 19.12.2024”.

Merkata e Rusit gjatë viteve të fundit ka pasur një rënie të numrit të tregtarëve për shkak të kushteve jo të mira të godinës. Gjendja e brendshme aktuale e ndërtesës së Markatës së Rusit është e amortizuar dhe të papërshtatshme për standardet bashkëkohore të tregtimit të produkteve ushqimore. Kjo ka bërë që edhe frekuentimi i kësaj Merkate nga blerësit të jetë i ulët. Për t’i dhënë zgjidhje kësaj situate dhe për të rikthyer funksionalitetin optimal të tregut, është propozuar një ndërhyrje infrastrukturore gjithëpërfshirëse. Ky projekt ka për qëllim përmirësimin e mjediseve të tregtimit, nëpërmjet rikonstruksionit fizik të godinës, modernizimit të ambienteve të brendshme si dhe organizimit funksional të hapësirave tregtare. Ndërhyrjet e parashikuara do të ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së shërbimit publik dhe në krijimin e kushteve optimale për zhvillimin e aktivitetit tregtar.

Përveç përmirësimit të infrastrukturës, ndërhyrja synon edhe formalizimin e plotë të aktivitetit tregtar në këtë zonë, në përputhje me standardet bashkëkohore të tregtimit me pakicë. Në këtë mënyrë, projekti pritet të japë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal dhe në promovimin e produktit vendas, duke e pozicionuar këtë treg si një pikë atraktive për qytetarët dhe vizitorët. Kjo do të bëhet përmes krijimit të një tregu që plotëson të gjitha standardet bashkëkohore të tregtimit me pakicë, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik lokal dhe promovimin e produktit vendas si një atraksion më vete.

**ii. Synimi i projektit**

Qëllimi i projektit është rikualifikimi i godinës së Merkatës së Rusit përmes ridimensionimit të hapësirave ekzistuese, duke krijuar një mjedis funksional, të sigurt dhe higjienik që ofron kushte optimale për tregtimin e produkteve, rrit frekuentimin e banorëve dhe vizitorëve, dhe promovon zhvillimin e ekonomisë lokale.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

1. Projekti i zbatimit
2. Tenderimi
3. Ndërtimi I Merkatës së Rusit sipas standarteve bashkëkohore
4. Mbikëqyrja e punimeve dhe kolaudimi

**b) Rezultatet që prisni**

a) Përmirësim i dukshëm i kushteve të punës dhe tregtimit për tregtarët, duke siguruar ambiente më funksionale, të sigurta dhe higjenike.
b) Rritje e frekuentimit të tregut nga blerësit, që do të ndikojë pozitivisht në zhvillimin ekonomik lokal.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Bashkia Shkodër<br>Fermerët | Bashkia shkodër |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Zbatim i Investimit për Rikualifikim të Godinës së Merkatës | | | | | | |
| A.2 | Mbikqyrje | | | | | | |
| A.3 | Kolaudim | | | | | | |
| | **Shuma** | | | | | | |

| **f) Periudha e zbatimit 2027,2028,2029** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Drejtoria e Planifikimit strategjik dhe e Përmirësimit të Klimës së Biznesit<br>Drejtoria e Studimeve, Planifikimit dhe Koordinimit të Investimeve<br>Drejtoria e Shërbimeve Publike<br><br>Institucioni likujdues: **Bashkia Shkodër** |
|---|---|

| Nr. 14 | **P.AC141.Q3.O1.A1.** Hostim, mirembajtje, perditesim dhe sherbime shtesë për Web sitin e turizmit. | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Një ndër instrumentet më të fuqishëm dhe më aktual të promocionit është promovimi online. Krijimi i një faqeje të dedikuar për turizmin është i rëndësishëm pasi përveç se shërben si një platformë për të shpërndarë informacion rreth një destinacioni, duke lehtësuar planifikimin e udhëtimit për vizitorët, vepron dhe si një mjet i fuqishëm marketingu, duke promovuar veçoritë dhe atraksionet unike të Bashkisë Shkodër. Duke ofruar harta interaktive, rekomandime të personalizuara dhe përditësime në kohë reale, kjo faqe ëebi do të përmirësojë përvojën e përgjithshme të vizitorëve. Nëpërmjet veçorive si vlerësimet e përdoruesve dhe integrimi i mediave sociale nxitet angazhimin i përdoruesve. Udhëtarët mund të ndajnë përvojat e tyre, duke ofruar komente të vlefshme dhe duke ndikuar në vendimet e udhëtimit të të tjerëve. Përditësimi dhe mirëmbajtja e faqes është thelbësore për ruajtjen e saktësisë, rëndësisë, besimit të përdoruesve dhe konkurencës. Siguron që platforma të mbetet një burim i besueshëm dhe i vlefshëm si për vizitorët e mundshëm ashtu edhe për komunitetin lokal.

**ii. Synimi i projektit**

Synohet promovimi i destinacionit, përmirësimi i informacionit për vizitorët me qëllim zhvillimin ekonomik të bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Hostimi.
- Mirëmbajtja.
- Përditësim e shërbime shtesë.

**b) Rezultatet që prisni**

Ëebsite i mirëmbajtur dedikuar turizmit të Bashkisë Shkodër.

| c) Aktorët e mundshëm | d) Kontributet e mundshme në projekt |
|---|---|
| • Drejtoritë e ndryshme të Bashkisë (E Turizmit, e Kulturës, e Planifikimit të Territorit, Planifikimit Strategjik, e të Ardhurave etj.<br>• Universiteti i Shkodrës<br>• Bizneset | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit.<br>• Shoqata e Artizanëve<br>• ATA |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| Shpenzimet për çdo aktivitet 2027 | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për Web-sitin e turizmit. | 150 | | | 150 | | |
| | **Shuma** | **150** | | | **150** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lek | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për Web-sitin e turizmit. | 150 | | | 150 | | |
| | **Shuma** | **150** | | | **150** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lek | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për Web-sitin e turizmit. | **150** | | | 150 | | |
| | **Shuma** | **150** | | | **150** | | |

| f) Periudha e zbatimit | g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit: |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2027-2029 | Stafi i drejtorisë së Turizmit.<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

<table>
<tr><td>Nr. 15</td><td colspan="6">P.AC141.Q3.O1.A2.Hostim , mirëmbajtje , pëditesim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit</td><td colspan="3">Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural</td></tr>
<tr><td colspan="10">a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:</td></tr>
<tr><td colspan="10">i. Situata</td></tr>
<tr><td colspan="10">Zhvillimi i turizmit është gjithnjë e më shumë në fokusin e Bashkisë Shkodër dhe githashtu vërehet një interes gjithnjë e në rritje i turistëve të huaj dhe vendas. Përparimet teknologjike i kanë dhënë mundësinë të gjithëve për të pasur akses më të shpejtë e më të lire në informacionin për destinacione të caktuara. Krijimi i aplikacionit synon që të lehtësojë udhetimin e turistëve vendas dhe sidomos të huaj nëpër pikat e ndryshme turistike të Shkodrës në zbulim të trashëgimisë historike, natyrore e kulturore. Në të njëjtën kohë, ky aplikacion do të ndihmojë edhe bizneset e ndryshme që ofrojnë shërbime turistike për të zgjeruar aktivitetin e tyre, duke reklamuar në faqen e dedikuar të aplikacionit. Risia që do i ofrohet turistëve është vetë aplikacioni offline në ndihmë të klientëve, për të kursyer në tarifat e Internetit roaming apo për të zgjidhur pamundësinë e të pasurit Wi-Fi. Çdokush mund ta organizojë udhëtimin e tij nëpërmjet aplikacionit që do të jetë në celularin e tij në çdo moment, gjë që kursen jo vetëm shpenzime, por edhe kohë. Ky do të ishte një hov cilësor për tregun e turizmit në Shkodër, sepse është mundësia që ndryshimet të përditësohen nëkohë të shpejtë. Për të ofruar një cilësi sa më të lartë shërbimi të informacionit për turistët dhe për të përmirësuar sigurinë nevojitet që aplikacioni të mirëmbahet dhe azhornohet<br>në vazhdimësi. Kjo do ndikonte mjaft në zhvillimin e mëtejshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër.</td></tr>
<tr><td colspan="10">ii. Synimi i projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">Synohet përmirësimi dhe lehtësimi i aksesit të informacionit për vizitorët.</td></tr>
<tr><td colspan="10">iii. Aktivitetet kryesore të projektit</td></tr>
<tr><td colspan="10">• Dizenjimi dhe krijimi i platformës<br>• Hostimi.<br>• Mirëmbajtja.<br>• Përditësim e sherbime shtese.</td></tr>
<tr><td colspan="10">b) Rezultatet që prisni</td></tr>
<tr><td colspan="10">Një aplikacion dinamik për turizmin informacioni lehtësisht të arritshëm.</td></tr>
<tr><td colspan="7">c) Aktorët e mundshëm</td><td colspan="3">d) Kontributet e mundshme në projekt</td></tr>
<tr><td colspan="7">• Stafi i Bashkisë.(Drejtoria e Turizmit, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Përmirësimit të Klimës së Biznesit, etj)<br>• Agjensia Kombëtare e Turizmit</td><td colspan="3">• Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit.<br>• ATA</td></tr>
<tr><td colspan="10">e) Shpenzimet e llogaritura</td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2027</td><td rowspan="2">Totali<br>(mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.</td><td>0</td><td></td><td></td><td>0</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td>0</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2028</td><td rowspan="2">Totali<br>(mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.</td><td>0</td><td></td><td></td><td>0</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td>0</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2" rowspan="2">Shpenzimet për çdo aktivitet 2029</td><td rowspan="2">Totali<br>(mije lekë)</td><td colspan="5">Nga kjo:</td></tr>
<tr><td>Paga</td><td>Sigurime</td><td>Operative</td><td>Transferime</td><td>Kapitale</td></tr>
<tr><td>A.1</td><td>Hostim, mirëmbajtje, përditësim dhe shërbime shtesë për aplikacionin e turizmit.</td><td>0</td><td></td><td></td><td>0</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td></td><td>Shuma</td><td>0</td><td></td><td></td><td>0</td><td></td><td></td></tr>
<tr><td colspan="2">f) Periudha e zbatimit<br><br>Janar - Dhjetor 2027-2029</td><td colspan="6">g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:<br>Stafi i drejtorisë së turizmit.<br><br>Institucioni likujdues: Bashkia Shkodër</td></tr>
</table>

| Nr. 16 | **P.AC141.Q3.O1.A3.** Prodhim, publikim dhe botim I materialeve promocionale | **Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural** |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

**i. Situata**

Turizmi është një sektor prioritar i zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror edhe për ekonominë e bashkisë Shkodër. Ai gjeneron të ardhura më të larta për faktin që një sërë aktivitetesh ekonomike janë të lidhura me të, si dhe garanton punësim dhe mundësi vetëpunësimi. Me pasuri të veçanta natyrore, historike dhe me një pasuri të trashëgimisë kulturore, Shkodra ka një potencial të jashtëzakonshëm turistik. Për të krijuar një identitet më të njohur për turizmin në Shkodër, për të përmirësuar konkurrencën dhe për të përmirësuar pozicionin në tregun turistik kombëtar, rajonal si dhe duke parë fluksin e turistëve dhe mbajtjen e tyre sa më gjatë në destinacionin tone, Drejtoria e Turizmit çdo vit ka realizuar botime të ndryshme dhe prodhuar materiale promociale (guidën turistike, harten turistike të territorit të Bashkisë; harta të destinacioneve specifike- Shkodër; Theth dhe Velipojë; itinerare të ndryshme turistike, kalendarin e aktiviteteve kulturore dhe artistike, materiale të ndryshme promocionale dhepublikime online si reklama etj. Për vitet në vazhdim, është menduar që fondi i parashikuar për realizimin e këtyre aktiviteteve të kryhet me blerje të përqendruar. Të gjitha materialet promocionale që do të realizohen do të jenë në dispozicion të zyrave të informacionit turistik të Bashkisë falas.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i informacionit turistik dhe diversifikim i ofertës turistike të Bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Përmirësimi dhe rifreskimi i i informacionit në territorin e Bashkisë Shkodër.
- Prodhimi dhe botimi I materialeve promocionale
- Shpërndarja e materialeve.

**b) Rezultatet që prisni**

Rritja e numrit të turistive dhe kohëzgjatja e sezonit turistik në Bashkinë Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë, Drejtoria e turizmit | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit. |

**e) Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale. | **2,500** | | | 2,500 | | |
| | **Shuma** | **2,500** | | | 2,500 | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale. | **2,500** | | | 2,500 | | |
| | **Shuma** | **2,500** | | | **2,500** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Prodhim, publikim dhe botim i materialeve promocionale. | **2,500** | | | 2,500 | | |
| | **Shuma** | **2,500** | | | **2,500** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar – Dhjetor 2027-2029 | Stafi i Drejtorisë së Turizmit.<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.17 | **P.AC141.Q3.O1.A4** Përmirësimi i aksesit dhe mirëmbajtja e shtigjeve | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Territori i bashkisë Shkodër është ndër zonat më të pasura me burime natyrore, ku përfshihen edhe destinacionet më të frekuentura sa i takon turizmit natyror dhe atij malor. Këto zona turistike frekuentohen nga turistë kryesisht të huaj, të apasionuar pas ecjes në natyrë, alpinizmit, sporteve të aventurës por edhe për interesimin ndaj mënyrës autentike të jetesës së banorëve të zonës. Brenda zonave turistike ka mjaft pika tërheqëse me interes për vizitorët, të cilat vizitohen duke ecur në këmbë në shtigje që njihen nga guidat turistike të zonës. Këto shtigje kanë nevojë që të paisen me sinjalistikë të përshtatshme pasi ka një numër të madh vizitorësh të cilët vijnë në mënyrë të paorganizuar. Të gjitha facilitetet, përfshirë zonat rekreative dhe shtigjet për ecje, kanë nevojë për mirembajtje të rregullt për
të zvogëluar dëmin e shkaktuar me kalimin e kohës dhe nga përdorimi. Mirëmbajtja e duhur është themelore për të garantuar sigurinë e vizitorëve, lehtësi në kalim, dhe për të inkurajuar përdorimin e itinerarit të caktuar.

**ii. Synimi i projektit**

Përmirësimi i shërbimit dhe informacionit për vizitorët.

iii. Aktivitetet kryesore të projektit

- Identifikimi i nevojave për ndërhyrje në shtigje për pajisje me sinjalistikën dhe mirëmbajtjen e tyre.
- Pregatitja e dokumentacionit tekniko-ligjor për garën e hapur për kryerjen e punimeve.
- Kryerja e punimeve

**b) Rezultatet që prisni**

Markimi i shtigjeve dhe paisja me sinjalistikën përkatëse e shtigjeve.
Përmirësimi i standarteve dhe ofrimit të shërbimit përmes mirëmbajtjes së shtigjeve

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| – Stafi i Bashkisë<br>– Bizneset turistike<br>– Universiteti | – Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferim e | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve | 1,000 | | | 1,000 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | 1,000 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferim e | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve | 1,000 | | | 1,000 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | 1,000 | | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferim e | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Përmirësim i aksesit dhe mirembajtje e shtigjeve | 1,000 | | | 1,000 | | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | 1,000 | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.18 | **P.AC141.Q3.O1.A5.** Pjesëmarrje në panaire kombetare dhe ndërkombëtare për ofertën turistike të Shkodrës | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Zhvillimi i turizmit në zonën e Shkodrës, ka ecur me shpejtësi. Nga viti në vit, numri i turistëve dhe vizitorëve ka ardhur në rritje. Rrajoni jonë ofron një gamë të gjërë të produkteve bujqësore dhe gastronomike me shije krejt të veçanta që përbëjnë një element shumë të rëndësishëm të ofertës turistike të rajonit. Një sinergji më e konsoliduar mes bizneve turistike dhe atyre të produkteve bujqësore dhe gastronomike do të krijonte mundësinë për produktetë reja turistike duke rritur ndjeshëm numrin e tyre por edhe duke i përmirësuar cilësisht ato. Të gjithë këto vlera të qytetit tonë duhtet të bëhen të njohura ndërkombëtarisht dhe pjesëmarrja në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare është një alternativë mjaft e mirë për këtë qëllim.

**ii. Synimi i projektit**

- Promovimi i destinacionit përmes diversifikimit të ofertës turistike të territorit të Bashkisë Shkodër në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

**iii. Aktivitetetkryesore të projektit**

- Mbledhja dhe sistemimi i informacionit për materialin që do prezantohet në panaire.
- Prodhimi i materialeve promocionale per stendën e panairit.
- Pjesëmarrja në panaire.

**b) Rezultatet që prisni**

- Vizitorët që marrin pjesë në panair do të kenë një informacion më të plotë dhe të përditësuar për atraksionet dhe produktet turistike tëterritorit të Bashkisë Shkodër.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet emundshmenëprojekt** |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë<br>• Bizneset turistike | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesëmarrje në panair (Organizim i te gjitha detajeve per realizimin e panairit) | **1,500** | | | 1,500 | | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | **1,500** | | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesëmarrje në panair (Organizim i te gjitha detajeve per realizimin e panairit) | **1,500** | | | 1,500 | | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | **1,500** | | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Pjesëmarrje në panair (Organizim i te gjitha detajeve per realizimin e panairit) | **1,500** | | | 1,500 | | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | **1,500** | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjekrealizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.19 | **P.AC141.Q3.O1.A6.** Itineraret e shijes/promovimi i Slow food | Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Shkodra njihet jo vetëm për natyrën e bukur, por edhe historinë, kulturën, rrugicat karakteristike si dhe artin e gatimit, që përcillet me aq finesë. Panairet e kulinarisë do të jenë një udhëtim përmes trashëgimisë së pasur gastronomike, kulturore, artistike, historike dhe bukurive natyrore të Shkodrës. Këto aktivitete syojnë t'i kthejnë Shkodrës vendin që i takon si një qytet ku turizmi zhvillohet mbi rrënjët e forta të traditës dhe pasurive të pafundme të territorrit, ndërthurur me elementet që koha i dikton. Aktivitetet e kulinarisë synojnë të promovojnë itenerarët e shijes dhe traditën e pasur gastronomike në territorin e bashkisë Shkodër dhe të rajonit.

**ii. Synimi i projektit**

- Rritja e numrit të turisteve në territorin e bashkisë Shkodër.

**iii. Aktivitetetkryesore tëprojektit**

- Realizimi i panairit me bizneset lokale
- Organizimi i aktiviteteve si konkurse gatimi, degustime kulinarie, trajnime në fushën gastronomisë etj
- Program artistik
- Fushatë promovuese

**b) Rezultatet që prisni**

- Promovimi i gastronomisë dhe produkteve lokale

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet emundshmenëprojekt** |
|---|---|
| • Stafi i Bashkisë<br>• Bizneset turistike | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Aplikim i projektit – mbledhja e keshillit artistik- dalja e fituesit dhe realizimi i aktivitetit. (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinarie/ trajnimeve ne fushen e gastronomise; program artistk dhe fushatë promovuese) | **1,500** | | | | 1,500 | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | | 1,500 | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Aplikim i projektit – mbledhja e keshillit artistik- dalja e fituesit dhe realizimi i aktivitetit. (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinarie/ trajnimeve ne fushen e gastronomise; program artistk dhe fushatë promovuese) | **1,500** | | | | 1,500 | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | | 1,500 | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Aplikim i projektit – mbledhja e keshillit artistik- dalja e fituesit dhe realizimi i aktivitetit. (Organizimi i panairit, konkurse gatimi/degustime kulinarie/ trajnimeve ne fushen e gastronomise; program artistk dhe fushatë promovuese) | **1,500** | | | | 1,500 | |
| | **Shuma** | **1,500** | | | | 1,500 | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjekrealizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.20 | **P.AC141.Q3.O1.A7.** Festa e Liqenit | **Programi AC141**: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Liqeni i Shkodrës përbën një ekosistem të rëndësishëm vlerash natyrore që ndërthuren me vlera historike e kulturore. Si liqeni më i madh në Rajonin e Ballkanit dhe zonë e mbrojtur e kategorisë IV - Rezervat Natyror i Menaxhuar, e bën një zonë me shumë vlera ekologjike me fokus zhvillimin e qëndrueshëm.
Fundjava e javës së tretë të muajit qershor është përcaktuar si Dita e Liqenit të Shkodrës, e cila është një ditë e përbashkët e aprovuar nga të dy ministritë e Mjedisit respektive të Shqipërise dhe Malit te Zi. Aktivitete të larmishme, për diten e Liqenit të Shkodrës zhvillohen për çdo vit të cilët fokusohen në aktivitete promovuese social- kulturore, sportive me qëllim ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e kësaj trashëgimie të pasur natyrore të qytetit si dhe në promovimin e produkteve rajonale dhe bizneseve lokale të Shkodrës.

**ii. Synimi i projektit**

- Te promovoje dhe te mbeshtese zhvillimin e ekoturizmit ne Liqenin e Shkodres;

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Organizimi i një sërë aktivitetesh sportive ujore:
- Ekspozita fotosh nga liqeni etj
- Panairi i artizanatit dhe kulinarise tradicionale
- Koncert kenge dhe valle me talentet te reja te qytetit

**b)Rezultatet që prisni**

- Promovimi i liqenit të Shkodrës si një burim ekonomik dhe turistik si edhe ndërgjegjësim i komunitetit për vlerat e tij mjedisore dhe të biodiversitetit.

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet emundshmenëprojekt** |
|---|---|
| • Bashkia Shkoder<br>• Universiteti "LuigjGurakuqi" | • Bashkia Shkodër.<br>• OJF dhe TO |

e) Shpenzimet ellogaritura

| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | OperatIve | TransferIme | Kapitale |
| A.1 | Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive, baner, postera, lajmërime, bluza, kapele, çertifikata, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | OperatIve | TransferIme | Kapitale |
| A.1 | Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive,baner, postera, lajmërime, bluza, kapele,çertifikata, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |
| | **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | OperatIve | TransferIme | Kapitale |
| A.1 | Zhvillim i aktivitetit (transport, foni, Dj, qira mjete lundruese, paisje për aktivitetet sportive,baner, postera, lajmërime, bluza, kapele,çertifikata, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhendjekrealiziminеprojektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria eTurizmit<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.21 | **P.AC141.Q3.O1.A8.** Valorizimi dhe mbrojtja e trashëgimisë së zonave malore,permes aktiviteteve promovuese. | Programi AC141: Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Rigjallërimi i trashëgimisë dhe zhvillimi i turizmit te zonave malore duke mbështetur promovimin e diversitetit kulturor dhe natyror ne keto zona, mbetet nje nder prioritet kryesore te Bashkise Shkoder. Qëllimi kryesor është të ngreje vetëdijen dhe të kuptuarit e vlerës së trashëgimisë ekzistuese si dhe të sigurohet përjetimi i kënaqësisë dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve të trashëgimisë nga komunitetet lokale. Zona e Alpeve është një nga destinacionet më atraktive të territorit të Bashkisë Shkodër e më gjërë. Ajo ofron mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e shumë llojeve të turizmit malor dhe të aventurës. Zhvillimi i ketij aktiviteti është konceptuar në mënyrë të tillë, që të përmbajë sa më shumë elementë të traditës lokale dhe të promovojë në mënyrë sa më gjithë përfshirëse atraksionet e vecanta të ketij destinacioni.

**ii. Synimi i projektit**

- Promovimi i vlerave natyrore dhe kulturore të zonës së Alpeve.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Panair të vlerave tradicionale të zonës, si veshje popullore, tradita e kulinarisë, artizanati,
- Ekspozite me foto të jetës së egër nga kjo zonë,
- Koncert me këngë e valle të zonës së Alpeve
- Aktivitetet në natyrë si birdëatching, ture botanike, vizita në sitet dhe vizita në monumentet historike te zones
- Realizimi i materialeve promovuese

**b)Rezultatet që prisni**

- Mbeshtetja e iniciativave për aktivitete edukative dhe rekreative me fokus zhvillimin e turizmit në një mjedis të mirëmbajtur natyror

| **c)Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Bashkia Shkodër<br>• Bizneset përfituese të turizmit.OJF<br>• Universiteti i Shkodrës, | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet ellogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aplikim i projektit – mbledhja e keshillit artistik- dalja e fituesit dhe realizimi i aktivitetit. (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj) | 1,000 | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aplikim i projektit – mbledhja e keshillit artistik- dalja e fituesit dhe realizimi i aktivitetit. (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj) | **1,000** | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1000** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aplikim i projektit – mbledhja e keshillit artistik- dalja e fituesit dhe realizimi i aktivitetit. (materiale promicionale, transport, toure ne atraksionet turistike; panair; koncert, etj) | **1,000** | | | | 1,000 | |
| | **Shuma** | **1,000** | | | | **1,000** | |

| **f) Periudhaezbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria eTurizmit<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.22 | **P.AC141.Q3.O1.A9.** Java e Mobilitetit | **Programi AC141:** Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

Me qellim promovimin e lëvizjes se qëndrueshme urbane të qytetit, ku prioriteti i jepet ecjes dhe pedalimit per te nxitur lëvizjen aktive dhe të shëndetshme, Bashkia Shkoder i ka kushtuar nje një vëmendje te vecante aplikimit të trendit të mobilitetit urban duke ndertuar korsite e bicikletave me nje shtrirje te gjere ne te gjithe qytetin duke u përfshirë në mënyrë aktive në promovimin dhe mbrojtjen e kësaj kulture dhe tradite. Si cdo vit, gjate javes se mobilitetit ne muajin shtator, eshte parashikur nje seri aktivitetesh qe shtrihen gjate gjithe javes me perfshirjen e shume aktoreve, nxenesve te shkollave dhe qytetareve.

**ii. Synimi i projektit**

- Ripërtëritja e traditës dhe promovimi i mënyrës së shëndetshme të jetesës

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Aktivitete të ndryshme me fokus biçikleten
- Xhiro demostrative m ebicikleta
- Ekspozitë / konkurs fotografie
- Publikim i materialeve promocionale për përdorimin e biçikletës

**b) Rezultatet që prisni**

Realizimi i kësaj feste do të rrisën dërgjegjësimin qytetar për përdorimin e biçikletës dhe do të krijojë një atmosferë festivenë qytet.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d)Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • BashkiaShkoder<br>• DAR | • Bashkia Shkodër. |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aplikimi i projektit. – Mbledhja e Keshillit artistik- Fiuesi i projektit dhe Organizimi i aktivitetit sipas detajeve te projektit fitues | **500** | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | **500** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aplikimi i projektit. – Mbledhja e Keshillit artistik- Fiuesi i projektit dhe Organizimi i aktivitetit sipas detajeve te projektit fitues | **500** | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | **500** | |

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | Aplikimi i projektit. – Mbledhja e Keshillit artistik- Fiuesi i projektit dhe Organizimi i aktivitetit sipas detajeve te projektit fitues | **500** | | | | 500 | |
| | **Shuma** | **500** | | | | **500** | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria e Turizmit<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr.23 | **P.AC141.Q3.O1.A10.** Lojra Popullore Fest | **Programi AC141:** Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit**

**i. Situata**

"Lojra Popullore Fest" është një aktivitet me karakter social-kulturor për të rinjtë i cili synon jo vetëm të pasurojë jetën e të rinjve por edhe ti njohë ata me traditat tona kombëtare me anën këngëve, valleve dhe lojrave popullore. Qëllimi i aktivitetit është promovojë paqen, tolerancën, miqësinë në mes të trupave pjesëmarrëse. "Lojra popullore fest" gjithashtu synon që të pasurojë jetën e të rinjve duke i angazhuar ato në identifikimin e vlerave njerëzore e vlerave folklorike e kombëtare e ndërkombëtareVetë të rinjtë konkurojnë me performanca me lojra popullore, këngë e valle të traditave kombëtare dhe enografike. Projekti nxit rininë për promovimin e vlerave turistike. Ky aktivitet është kthyer në traditë për qytetin e Shkodrës.

**ii. Synimi i projektit**

- Të pasurojë jetën social kulturore të të rinjve.
- Të promovojë dhe t'i njohë ata me traditat e njesive administrative të Bashkisë Shkodër, te rajonit dhe me tej, me anë të performimeve të këngëve, valleve dhe lojrave popullore.
- Të përfshijë të gjithë njësite administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe rajonin, nëpërmjet përfaqësimit nga të rinjtë.

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

- Përzgjedhja e trupave kandidate për pjesëmarrje
- Ngritja e bashkëpunimit me trupat e përzgjedhura
- Përgatitja e ambjentit ku do zhvillohet aktiviteti: skena, sigurimi i nevojave bazë.

**b) Rezultatet që prisni**

Promovimi i vlerave dhe traditave kulturore të njësive administrative të Bashkisë së Shkodrës dhe angazhimi i të rinjve përmes një pjesmarrjeje të gjerë

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| Stafi i Bashkisë Shkodër (Drejtoria e Turizmit) Komuniteti<br>Institucione publike | Bashkia Shkodër.<br>Qendra Kulturore e femijeve ZVA<br>Shkoder |

e) Shpenzimet e llogaritura

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurme | Operative | Transferim e | Kapitale |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| A.1 | Aplikimi i projektit. – Mbledhja e Keshillit artistik- Fituesi i projektit dhe Organizimi i aktivitetit sipas detajeve te projektit fitues | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | 500 | | | | 500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferim e | Kapitale |
| A.1 | Aplikimi i projektit. – Mbledhja e Keshillit artistik- Fituesi i projektit dhe Organizimi i aktivitetit sipas detajeve te projektit fitues | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | 500 | | | | 500 | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mije lekë) | Nga kjo: Paga | Sigurime | Operative | Transferim e | Kapitale |
| A.1 | Aplikimi i projektit. – Mbledhja e Keshillit artistik- Fituesi i projektit dhe Organizimi i aktivitetit sipas detajeve te projektit fitues | 500 | | | | 500 | |
| | **Shuma** | 500 | | | | 500 | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027-2029 | Drejtoria e Turizmit<br><br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 24 | P.AC141.Q3.O1.A11. Fushata marketing online | **Programi AC141:** Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Fushata marketingut online është një aktivitet që përfshin përdorimin e kanaleve dhe mjeteve dixhitale për të promovuar një produkt, shërbim, markë ose kompani përmes internetit. Kjo lloj fushate është gjithnjë e më shumë e rëndësishme për bizneset dhe organizatat që kërkojnë të arrijnë një audiencë të gjerë dhe të përmirësojnë ndihmën për zhvillimin e shitjeve dhe rritjen e njohjes së markës. Marketingu online ka pësuar një zhvillim të jashtëzakonshëm në vitet e fundit, duke u bërë një komponent thelbësor për çdo strategji të biznesit dhe komunikimi. Si pasojë e avancimit të teknologjisë, rritjes së përdorimit të internetit, dhe ndryshimeve në sjelljen e konsumatorëve, marketingu online ka evoluar për t'u përshtatur me kërkesat e reja dhe për të krijuar mundësi të reja për të arritur audiencën.

**ii. Synimi i projektit**

Rritja e Ndikimit të Markës: Krijimi i njohjes dhe ndërtimi i besueshmërisë së markës

**iii. Aktivitetet kryesore të projektit**

Marketingu në rrjetet sociale
SEO (Optimizimi i motorëve të kërkimit) Email Marketing
Content Marketing

**b) Rezultatet që prisni**

Krijimi i nje imazhi cilesor dhe te qendrueshem te destinacionit.

| **c) Aktorët e mundshëm** | **d) Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| • Bashkia Shkodër<br>• Bizneset përfituese të turizmit.<br>• OJF Universiteti i Shkodrës,<br>• Fakulteti Ekonomik/Dega Turizëm | • Bashkia Shkodër.<br>• Bizneset përfituese të turizmit. |

**e) Shpenzimet e llogaritura ( për çdo aktivitet të mësipërm (pika iii)**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2027** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Fushata marketing online** | 500 | | | 500 | | |
| | **Shuma** | **500** | | | **500** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2028** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Fushata marketing online** | 500 | | | 500 | | |
| | **Shuma** | **500** | | | **500** | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2029** | | Totali (mijë lekë) | Nga kjo: | | | | |
| | | | Paga | Sigurime | Operative | Transferime | Kapitale |
| A.1 | **Fushata marketing online** | 500 | | | 500 | | |
| | **Shuma** | **500** | | | 500 | | |

| **f) Periudha e zbatimit** | **g) Përgatiti dhe ndjek realizimin e projektit:** |
|---|---|
| Janar - Dhjetor 2027- 2029 | Stafi i drejtorisë së Turizmit.<br>**Institucioni likujdues:** Bashkia Shkodër |

| Nr. 25 | **P.AC141.Q3.O1.A12.**<br>Shkodra: Histori dhe magji ne çdo hap: promovim ne levizje | **Programi AC141:** Mbështetje për zhvillim ekonomik vendor dhe rural |
|---|---|---|

**a) Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

i. Situata

Një stendë lëvizëse për një ngjarje, panair, ose ekspozitë në Shkodër mund të jetë një element shumë efektiv për të tërhequr vëmendjen e vizitorëve dhe për të promovuar produkte, shërbime ose marka. Kjo mund të jetë një stendë që mund të lëvizë fizikisht përreth, ose një dizajn i veçantë që përdor elemente dinamikë si ekrane të lëvizshëm, drita, ose efekte të tjera për të krijuar një përvojë tërheqëse.
Territori i bashkisë Shkodër gjithnjë e më tepër po sheh një numër në rritje të turizmit të brendshëmGjykojmë një mënyrë e mirë për të ndërgjegjësuar turistët dhe për t'i informuar ata mbi atraksionet dhe mundësitë që ofron territori i Bashkisë Shkodër do të ishte ngritja e një stende të lëvizshme që do të vendosej në qytete të ndryshme të Shqipërisë në ditë të caktuara. Kjo stendë do të përmbante materiale promocionale për Shkodrën duke bërë në këtë mënyrë të rritet interesi i qytetarëve të atij qyteti për të vizituar Shkodrën. Bashkë me stendën do të udhëtojë edhe një pjesë e stafit të drejtorisë të cilët do të kryjnë funksionin e informacionit turistik si edhe të promovimit të qytetit.

